# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5962
E martë, 24 dhjetor 2019
çmimi 0.40 €


Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

## Thaçi pranon urime për festat e fundvitit nga përfaqësues të shteteve të ndryshme

FAQE 2




AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


ALBIN KURTI E ISA MUSTAFA KANË EDHE TRI DITË KOHË PËR ARRITJEN E MARRËVESHJES PËR BASHKËQEVERISJE FAQE 4-5

# VAZHDOJNË POLEMIKAT NË MES TË LV-së DHE LDK-së PËR NDARJEN E PUSHTETIT

Polemikat në mes të zyrtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) kanë vazhduar edhe tri ditë para mbajtjes së mbledhjes së parë të legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Kosovës. Ata kanë treguar sërish vullnetin për të biseduar për arritjen e marrëveshjes, por kanë fajësuar njëri-tjetrin për pengesa në rrugën drejt arritjes së këtij qëllimi. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë të hënën se këto dy subjekte zgjedhjet e 6 tetorit i kanë nxjerrë gati si të barabarta. Ndërsa deputeti LV-së, Mefail Bajqinovci, ka vlerësuar se LDK-ja duhet të heqë dorë nga kërkesa e saj për postin e presidentit



KRYEMINISTRI NË DETYRË, RAMUSH HARADINAJ, KA NUMËRUAR SUKSESET DHE SFIDAT E QEVERISJES GJATË KËTIJ VITI

# HARADINAJ: KUR JEMI UNIKË JEMI MË TË FORTË

FAQE 3



Në konferencën e fundvitit me gazetarë, kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka folur për sukseset, sfidat, dhimbjet dhe krenaritë gjatë qeverisjes së tij për këtë vit. Duke folur për sukseset, ai ka thënë se Ushtria e Kosovës po konsolidohet në ushtri inteligjente me standarde të NATO-s dhe, sipas tij, gjatë këtij viti ka pasur transparencë të plotë në qëndrime politike, vendime dhe qasje në dokumente zyrtare. Ndërkaq sfida për këtë vit kryeministri ka thënë se kanë qenë liberalizimi i vizave, dialogu me Serbinë dhe taksa. "Orientimi i Kosovës është drejt BE-së e jo drejt izolimit rajonal. Drejt NATO-s e jo Rusisë", ka thënë ai. Kryeministri në detyrë ka thënë se kur jemi unikë jemi më të fortë. Ai ka thënë se të gjithë duhet të jemi bashkë kur janë në pyetje temat kombëtare

## OPINION

EPILOGU I PËRGJITHSHËM PËR LUFTËN E PASHTRIKUT F. 12

LULZIM SAHITI



## AKTUALE




PËRUROHET QENDRA E PARË E TRAJTIMIT TË SULMEVE NË TRU F. 7



KDI-ja: NË TETË SHKOLLA FILLORE NË GJILAN PËRDORET UJI I PAPIJSHËM F. 7

## EKONOMI

MEHMETI: RRITJA EKONOMIKE PËR KËTË VIT VLERËSOHET TË JETË 4.2 PËR QIND F. 9

81 PËR QIND E NDËRMARRJEVE NË KOSOVË PËRDORIN MEDIAT SOCIALE F. 9

## KULTURË

SOT HAPET PANAIRI I TURIZMIT NË PRIZREN F. 6


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht –Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666


Gëzuar Krishtlindjen
dhe Vitin e Ri
vala
KOSOVO TELECOM
www.kosovotelecom.com


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues

## Rama: Brenda gjashtë muajve, të prekurit nga tërmeti në shtëpi të re

TIRANË, 23 DHJETOR - Kryeministri Edi Rama deklaroi të hënën se plani për rindërtimin pas tërmetit parashikon që brenda pranverës gjithçka të jetë e nisur. Duke folur në një komunikim me median pas mbledhjes së fundvitit të kabinetit qeveritar zhvilluar në Durrës, kryeministri Rama theksoi se "brenda gjashtëmujorit të parë një pjesë e madhe e atyre që janë sot në banesa individuale të jenë sistemuar në një shtëpi të re".

Rama u shpreh se një pjesë e rëndësishme e mbledhjes së sotme ishte për rindërtimin. "Besoj se kemi një plan shumë solid për ta nisur procesin e rindërtimit. Objektivi ynë është që brenda pranverës gjithçka të jetë e nisur dhe brenda gjashtëmujorit të parë një pjesë e madhe e atyre që janë sot në banesa individuale të jenë sistemuar në një shtëpi të re", tha kreu i qeverisë. "Sigurisht për ata që do të hyjnë në apartamente në lagjet e reja që do të ndërtohen do të vazhdojnë të qëndrojnë në sistemin e qirasë deri kur të jenë gati për të ardhur në shtëpitë e reja", tha Rama. "Sa i përket energjisë dhe infrastrukturës, kemi nisur procedurën për Aeroportin e Vlorës. Shumë shpejt do të shpallet procedura për parkun e madh të Fotovoltaike në zonën e Divjakës. Shumë shpejt do të shpallet procedura për rrugën e re që do të ndërtohet tërësisht nga e para, Thumanë-Kashar-Rrogozhinë, pra një segment Thumanë - Rrogozhinë. Po ashtu, po punohet dhe shpejt do të shpallet procedura për tunelin e Llogorasë, që është një tjetër vepër e rëndësishme publike, pastaj një sërë veprash të tjera,



Shëngjin - Velipojë, e të tjera vepra goxha të rëndësishme", tha Rama.

Kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka numëruar sukseset dhe sfidat e qeverisjes gjatë këtij viti

# Haradinaj: Kur jemi unikë jemi më të fortë

**Në konferencën e fundvitit me gazetarë, kryeministri në detyrë, Ramush Haradinaj, ka folur për sukseset, sfidat, dhimbjet dhe krenaritë gjatë qeverisjes së tij për këtë vit. Duke folur për sukseset, ai ka thënë se Ushtria e Kosovës po konsolidohet në ushtri inteligjente me standarde të NATO-s dhe, sipas tij, gjatë këtij viti ka pasur transparencë të plotë në qëndrime politike, vendime dhe qasje në dokumente zyrtare. Ndërkaq sfida për këtë vit kryeministri ka thënë se ka qenë liberalizimi i vizave, dialogu me Serbinë dhe taksa. "Orientimi i Kosovës është drejt BE-së e jo drejt izolimit rajonal. Drejt NATO-s e jo Rusisë", ka thënë ai. Kryeministri në detyrë ka thënë se kur jemi unikë jemi më të fortë. Ai ka thënë se të gjithë duhet të jemi bashkë kur janë në pyetje temat kombëtare**



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Kryeministri Ramush Haradinaj në konferencën e fundvitit me gazetarë ka folur për sukseset, sfidat, dhimbjet dhe krenaritë gjatë qeverisjes së tij për këtë vit. Po ashtu, ai ka folur edhe për dorëheqjen e tij për shkak të ftesës nga Gjykata Speciale. "Unë, po ashtu, isha i sfiduar me ftesën e papritur në moment kritik. Dorëheqja ime testoi Kosovën për të dëshmuar se demokracia jonë është stabile dhe se në kohë krizash vendimmarrja i kthehet sovranit", ka thënë Haradinaj.

Ai në këtë konferencë ka listuar sukseset e punës së vet në këto tema. "Ushtria e Kosovës po konsolidohet në ushtri inteligjente me standarde të NATO-s, Kosova ka arritur pavarësinë energjetike dhe 'Trepça' është gati për investime, investitori i parë strategjik SOWI + Parku ITP - me Gjermaninë, shtrirja e sundimit të rendit dhe ligjit edhe në veri të vendit, dhe transparencë e plotë në qëndrime politike, vendime dhe qasje në dokumente zyrtare. Tanimë është bërë ndryshimi duke instaluar kulturën qeverisëse me llogaridhënie të plotë", ka thënë Haradinaj.

Duke folur për sfidat, ka përmendur liberalizimin e vizave, dialogun me Serbinë dhe taksën. "Injorimi i arritjeve të Kosovës drejt liberalizimit të vizave për arsye politike nga BE-ja; rikthimi i dialogut në binarë, pra dialog mes shteteve e jo dialog për nënshtrim. Kjo logjikë duhet të vazhdojë deri në njohje reciproke në kufijtë ekzistues pa vonesa e sfida artificiale, mbajtja e taksës 100 për qind e cila nuk e pengon reciprocitetin. Tentimet për minishengen dhe reciprocitet bëhen për ta hequr taksën dhe nënshtruar Kosovën. Orientimi i Kosovës është drejt BE-së e jo drejt izolimit rajonal. Drejt NATO-s e jo Rusisë. Dhe keqpërdorimi i ndjenjave fetare për përfitime gjeopolitike është i rrezikshëm dhe ne duhet të jemi bashkë për luftimin e kësaj", ka thënë Haradinaj.

Si dhimbje gjatë këtij viti, kryeministri ka përmendur tërmetin në Shqipëri, sulmet terroriste anembanë botës. Ai ka thënë se Kosova qëndron fuqishëm përkrah ShBA-së dhe aleancës globale kundër terrorizmit. Ndërkaq si veprime që i kanë bërë krenarë qytetarët e Kosovës, Haradinaj ka përmendur sukseset e rinisë së Kosovës në sport e kulturë që, sipas tij, kanë mahnitur botën. Kryeministri në detyrë ka thënë se kur jemi unikë jemi më të fortë. Ai ka thënë se të gjithë duhet të jenë bashkë kur janë në pyetje temat kombëtare. "Kalkulimet për një grusht votash nuk e bëjnë shtetin", ka thënë Haradinaj.

## Vasili: Edi Rama tradhtoi Kosovën

TIRANË, 23 DHJETOR - Nënkryetari i LSI-së, Petrit Vasili, e cilësoi projektin e minishngenit të Ballkanit si një tradhti kombëtare të kryeministrit Edi Rama ndaj Kosovës. Në një deklaratë për mediat, Vasili u shpreh se me minishengenin "Edi Rama tregoi qartë qëndrimin më të egër ndaj Kosovës dhe me tradhtarin".

Vasili deklaroi se kryeministri Edi Rama u bë pjesë e një projekti që nuk ka të bëjë me interesat kombëtare dhe evropiane, por me interesat e oligarkëve. Sipas tij, projekti i minishengenit është edhe kundër qëndrimit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për rajonin dhe Kosovën. "Minishengeni, duke iu kundërvënë edhe ShBA-së, synon ta lë mënjanë dhe anashkalojë Kosovën. Edi Rama tregoi qartë qëndrimin më të egër ndaj Kosovës dhe më tradhtarin", deklaroi Petrit Vasili.




EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

# Riorganizimi i qeverisë, efektet dhe pasojat e zvogëlimit të ministrive

Demokraci Plus (D+) ka prezantuar të hënën një analizë të shkurtër mbi efektet dhe pasojat e organizimit të Ministrisë së Integrimeve Evropiane në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe organizimin e Ministrisë së Administratës Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme. "Ministria e Integrimeve Evropiane duhet të organizohet si agjenci ekzekutive me funksione koordinuese horizontale në kuadër të zyrës së kryeministrit. Ky opsion eliminon të gjitha efektet negative në agjendën për integrime evropiane që potencialisht mund të ketë integrimi i MIE-së në MPJ; Ministria e Administratës Publike duhet të mbetet ministri për shkak të funksioneve dhe rolin qendror që ka në reformën e administratës publike", ka thënë Visar Rushiti, analist i politikave Demokraci Plus (D+)



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Demokraci Plus (D+) ka mbajtur të hënën tryezë diskutimi lidhur me efektet dhe pasojat e organizimit të Ministrisë së Integrimeve Evropiane në Ministrinë e Punëve të Jashtme në agjendën për integrime evropiane. Po ashtu, organizimin e Ministrisë së Administratës Publike në Ministrinë e Punëve të Brendshme në reformën e administratës publike. Në këtë diskutim morën pjesë përfaqësues të dy ministrive përkatëse, përfaqësues të Lëvizjes Vetëvendosje, ekspertë të fushave që mbulojnë dy ministritë, përfaqësues nga zyra e BE-së, si dhe pjesëtarë të organizatave të shoqërisë civile.
Visar Rushiti, analist i politikave në D+, ka prezantuar një analizë të shkurtër mbi efektet dhe pasojat e integrimit të këtyre dy ministrive duke dhënë opsione dhe rekomandime mbi elementet që duhet të merren parasysh nga qeveria në akomodimin e dy ministrive në MPJ, përkatësisht MPB. "Ministria e Integrimeve Evropiane duhet të organizohet si agjenci ekzekutive me funksione koordinuese horizontale në kuadër të zyrës së kryeministrit. Ky opsion eliminon të gjitha efektet negative në agjendën për integrime evropiane që potencialisht mund të ketë integrimi i MIE në MPJ; Ministria e Administratës Publike duhet të mbetet ministri për shkak të funksioneve dhe rolin qendror që ka në reformën e administratës publike", ka thënë Rushiti.
Taulant Kryeziu nga Vetëvendosja ka thënë se pasi që të arrihet marrëveshja për koalicion me LDK-në do të bëhet publike edhe mënyra se si do të duken ministritë. "Tash e kemi kuptuar se procesi i integrimit bie mbi çdo ministri dhe jo vetëm në atë të MIE-së. Janë tri modalitete që unë dua t'i përmend sa i përket kësaj çështje. Është modaliteti i parë siç e ka Serbia dhe deri më tani e kishte edhe Kosova, pra të ketë Ministrinë e Integrimeve Evropiane. Modaliteti i dytë është ai i Shqipërisë dhe Malit të Zi që Ministria e Integrimeve është bashkuar me atë të Punëve të Jashtme dhe e treta është siç e ka Bullgaria, të veprojë në bazë të kryeministrit të vendi", u shpreh Kryeziu.
Artan Çollaku, përfaqësues i Ministrisë së Integrimeve Evropiane, ka theksuar se pse duhet të mbesë kjo ministri dhe të përforcohet roli i saj. "E para, vendimmarrja të jetë koherente, reformat të bëhen si reforma të brendshme; e dyta, llogaridhënia ndaj BE-së të jetë e centralizuar; e treta, komunikimi me aktorë politikë, konsensus jo vetëm deklarativë, por edhe institucionet ta ruajnë pavarësinë e tyre, qeveria ta luajë rolin e saj në ndarje të resurseve. Ministritë të mos jenë të politizuara", ka thënë Çollaku.
Naser Shamolli, përfaqësues i Ministrisë së Administratës Publike, vuri në pah se ku duhet të bazohet elementi i riorganizimit të kësaj ministrie. "Meqenëse vendimi është në dorën e partive fituese, duhet ta kemi parasysh një element, çka do të ndodhë? Elementi i riorganizimit duhet të bazohet me konsekuencat ligjore sa i përket edhe stafit dhe këto procese nuk janë të thjeshta. MAP-i është gjithçka që nuk ka mundur të bashkohet diku tjetër", ka thënë Shamolli.
Besnik Vasolli, njohës i Integrimeve Evropiane, u shpreh se ka fare pak diskutim se si do të duket zvogëlimi i ministrive. "Deri tani kemi dëgjuar se do të kemi numër më të vogël të ministrive, por kemi shumë pak diskutim si do të duken këto shkrirje. Si do të shkrihen tri departamentet ligjore, tre sekretarë permanentë, zyrat etj", u shpreh ai.

## Disa nga pikat kryesore të analizës së Demokraci Plus (D+)

Ministria e Integrimit Evropian mund të bëhet pjesë e Ministrisë së Punëve të Jashtme në kuptim organizativ dhe strukturor, por në kuptim funksional ka efekte negative në agjendën për integrime evropiane sepse e bënë atë pjesë të punëve të jashtme, kurse agjenda për integrime evropiane në masë të madhe është agjendë e brendshme e reformave. Po ashtu, ulet niveli i përgjegjësisë së ministrive (departamenteve për integrim evropian), komunave dhe institucioneve të tjera në zbatimin e mëtejmë të obligimeve që dalin nga agjenda për integrime evropiane dhe kuadri profesional në MIE mund të shpërndahet nëpër departamentet e MPJ-së.
Ministria e Administratës Publike sipas funksioneve që ka nuk lidhet aspak me funksionet që ka Ministria e Punëve të Brendshme. Derisa MAP-i ka në fushëveprim shërbimin civil, organizimin dhe funksionimin e administratës, MPB ka të lidhur fushëveprimin e saj me rendin dhe sigurinë publike etj.

# KDI-ja: Në tetë shkolla fillore në Gjilan përdoret uji i papijshëm

GJILAN, 23 DHJETOR (ER) - Në tetë shkolla fillore të Komunës së Gjilanit që furnizohen me ujë nga puset është gjetur se uji është i kontaminuar në aspektin kimik dhe bakteriologjik.
Si rrjedhojë e një hulumtimi në terren të bërë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe nga analizat e siguruara nga Qendra Rajonale e Shëndetësisë Publike në Gjilan (QRSHP) rreth cilësisë së ujit në këto shkolla, kontaminimi i ujit në këto shkolla vjen si pasojë e vjetërsisë së filtrave të ujit dhe mosmirëmbajtjes së puseve.
Numri i nxënësve që vijojnë



mësimin në këto 8 shkolla është 1 317.
Sipas vlerësimeve të QRShP-së, uji i kontaminuar mund të bartë lloje të ndryshme të mikroorganizmave dhe, për rrjedhojë, mund të shkaktojë sëmundje infektive si tifoja, paratifoja, dizenteria dhe kolera.
Këto gjetje dhe rezultatet e raportit të QRShP-së, KDI-ja i ka shpalosur në një takim që është mbajtur më 18 dhjetor, me zyrtarët komunalë dhe drejtorët e shkollave. Në këtë tryezë, zyrtari nga drejtoria e shëndetësisë, Veton Uka, ka thënë që disa shkolla furnizohen nga basenet, ndërsa kapakët e betonit me të cilët mbulohen këto basene nuk janë të cilësisë së duhur. Po ashtu, Uka ka theksuar që gjatë sezonit të vjeshtës ndodh depërtimi i baktereve në këto basene duke shkaktuar kontaminimin e ujit.
Ajhane Sefiu nga QRShP-ja ka kërkuar që klorizimi i ujit në këto shkolla duhet të bëhet në mënyrë permanente, ndërsa ka rekomanduar që çdo fshat duhet të tentojë të ketë sistemin lokal të furnizimit me ujë, që do ta mundësonte përmirësimin e cilësisë së ujit në shkolla.
KDI-ja kërkon nga Komuna e Gjilanit të marrë masa të menjëhershme për mirëmbajtjen, pastrimin dhe rehabilitimin e këtyre puseve në mënyrë që këtyre nxënësve t'u garantohet furnizimi me ujë të pijshëm.
Aktivitetet janë realizuar në kuadër të projektit "Rritja e llogaridhënies së institucioneve të qeverisjes lokale", që mbështetet nga Ambasada Britanike në Prishtinë.



Albin Kurti dhe Isa Mustafa kanë edhe tri ditë kohë për arritjen e marrëveshjes për bashkëqeverisje

# Vazhdojnë polemikat në mes të LV-së dhe LDK-së për ndarjen e pushtetit

Polemikat në mes të zyrtarëve të Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) kanë vazhduar edhe tri ditë para mbajtjes së mbledhjes së parë të legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Kosovës. Ata kanë treguar sërish vullnetin për të biseduar për arritjen e marrëveshjes, por kanë fajësuar njëri-tjetrin për pengesa në rrugën drejt arritjes së këtij qëllimi. Lideri i LDK-së, Isa Mustafa, ka thënë të hënën se këto dy subjekte zgjedhjet e 6 tetorit i kanë nxjerrë gati si të barabarta. Ndërsa deputeti i LV-së, Mefail Bajqinovci, ka vlerësuar se LDK-ja duhet të heqë dorë nga kërkesa për postin e presidentit

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

**Prishtinë, 23 dhjetor** - Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) nuk kanë arritur ende marrëveshje për koalicionin qeverisës, ndonëse kanë mbetur 72 orë nga mbajtja e mbledhjes konstituive të Kuvendit të Kosovës. Albin Kurti dhe Isa Mustafa nuk janë takuar as të hënën për të biseduar për këtë çështje, ndërsa zyrtarët e këtyre partive kanë polemizuar në distancë.

Në shënimin e 30-vjetorit të themelimit të LDK-së, i pari i kësaj partie ka thënë se këto dy parti kanë dalë si të barabarta nga zgjedhjet e 6 tetorit. Ai ka vlerësuar se duhet ta respektojnë vullnetin e qytetarëve të Kosovës të dalë nga zgjedhjet e fundit. "Jam i bindur që LDK-ja ka arritur synimet jo si parti e parë, por me një deputet më pak. Por, ne e vlerësojmë votën e qytetarëve. LDK-ja ka treguar vullnet të qeverisë me LV-në dhe ta ndajë përgjegjësinë.



Kemi vlerësuar se pjesëmarrja duhet të jetë në harmoni me besimin qytetar. Ekipi ynë dhe unë po bëjmë përpjekje për ta arritur marrëveshjen. Në përpjekjet tona për bashkëqeverisje me LV-në jemi të vetëdijshëm për dallimet ideologjike si dhe të kaluarën, por duke vlerësuar vendimin e qytetarëve, po bëjmë përpjekje për të gjetur një rrugë", ka thënë ai.
Mustafa ka vlerësuar se zgjedhjet e 6 tetorit duhet të lexohen qartë nga dy subjektet politike. "LDK-ja i ka lexuar qartë rezultatet e 6 tetorit dhe ne besojmë se LV-ja duhet t'i lexojë këto rezultate, sepse jemi të barabartë me vetëm një deputet dallim. Jemi të interesuar ta japim kontributin tonë dhe ta mbajmë Kosovën si aleat besnik të BE-së dhe NATO-s dhe për mbajtjen e miqësisë me ShBA-në që e kemi edhe amanetit të peridentit Rugova", ka deklaruar ai.
Ndërsa nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Agim Veliu, ka bërë me dije se posti i presidenti i takon LDK-së. "Nuk po bisedohet për të lëshuar pe, por pozita e presidentit i takon LDK-së. Në këtë raport forcash që një parti të ketë edhe kryeministrin edhe presidentin", ka thënë Veliu, duke shtuar se emrin e presidentit do ta bëjnë publik kur të vije koha.
Ai ka deklaruar se kjo parti emrin e presidenti nuk e ka sot, por do ta ketë kur të vijë koha. "Jemi duke biseduar që ta gjejmë një zgjidhje. LDK-ja duhet ta ketë të drejtën për kandidatin për president. Emrin nuk e kemi sot, por kur të vijë koha do ta bëjmë publik", është shprehur Veliu.
Ndaj kësaj deklarate ka reaguar deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Mefail Bajqinovci. Në profilin e vet në "Facebook" ai ka shkruar se Vetëvendosja nuk është duke e kërkuar për vete postin e presidentit. "Nuk qëndron kjo që thotë z. Veliu. Vetëvendosje nuk po e kërkon për vete postin e presidentit. Ne po kërkojmë që për presidentin të mos flitet tash kur jemi duke e ndërtuar shumicën parlamentare për qeverisje, por kur të vijë koha. Dhe më e rëndësishmja, po kërkojmë president saktësisht ashtu sikurse e kërkon Kushtetuta e vendit", ka shkruar Bajqinovci në profilin e vet në "Facebook". Ai ka vlerësuar se kërkesa e LDK-së për ta pasur presidentin është në kundërshtimin me parimet e proklamuara të kësaj parti. "Kërkesa juaj për ta pasur presidentin në mënyrën se si po e kërkoni nuk e shpreh përkushtimin e stërthënë nga ju për LDK-në shtetformuese, perëndimore dhe që angazhohet për shtetin e së drejtës", ka shkruar Bajqinovci.
Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti dhe ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Isa Mustafa, pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 6 tetorit patën paralajmëruar se do të jenë të mjaftueshme 72 orë për të arritur një marrëveshje për krijimin e koalicionit qeverisës pas certifikimit të rezultateve të zgjedhjeve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më 27 nëntor ka certifikuar rezultatet e zgjedhjeve të 6 tetorit, ndërsa Kurti dhe Mustafa, edhe pas disa takimeve, nuk kanë arritur të pajtohen për marrëveshjen e koalicionit qeverisës. Të dy partive u kanë mbetur 72 orë deri në mbledhjen konstituive të Kuvendit të Kosovës, për të arritur eventualisht një marrëveshje për koalicion qeverisës. Të enjten, më 26 dhjetor, në orën 15:00 do të mbahet mbledhja e parë e legjislaturës së shtatë të Kuvendit të Kosovës.

# KPK-ja zgjedh kryeprokurorët e Prokurorisë Speciale dhe Prokurorisë Themelore të Prishtinës

PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Këshilli Prokurorial i Kosovës ka zgjedhur të hënën në takimin e rregullt Blerim Isufajn në detyrën e kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe Kujtim Munishin për kryeprokuror të Prokurorisë Themelore të Prishtinës për një mandat katërvjeçar.




Këtyre zgjedhjeve i ka paraprirë trajtimi i raporteve të komisioneve për rishqyrtim, të cilat kanë rekomanduar refuzimin e katër kundërshtimeve për procesin e përzgjedhjes së kandidatëve, raporte këto që u miratuan nga anëtarët e KPK-së.
Gjithashtu, Këshilli Prokurorial, i udhëhequr nga kryesuesi Bahri Hyseni, ka miratuar pas hedhjes së shortit themelimin e dy paneleve hetimore ndaj dy prokurorëve në Prokurorinë Themelore në Pejë.
Ndërkohë, në vijim të këtij takimi të 175-të, Këshilli Prokurorial ka shpallur tri konkurse të brendshme për avancim të prokurorëve në prokuroritë themelore në Prizren, Pejë dhe Mitrovicë.
Nga ana tjetër, në kuadër të raportimeve të rregullta, është aprovuar edhe Raporti për gjeografinë e krimit 2013-2018, i cili përmban të dhënat për veprat penale karakteristike, si dhe është aprovuar Raporti për vlerësimin e performancës së dy prokurorëve.

# Thaçi pranon urime për festat e fundvitit nga përfaqësues të shteteve të ndryshme

PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pranuar urime të shumta për festat e fundvitit. Presidenti i Gjermanisë, Frank Walter Steinmeier, si dhe kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel, e kanë uruar presidentin Thaçi për festat e fundvitit. "Ju dëshiroj juve dhe qytetarëve tuaj një sezon të kënaqshëm festiv, si dhe plot lumturi, paqe dhe shëndet për vitin 2020!", thuhet në urimin e presidentit Steinmeier.



Ndërsa në urimin e saj, kancelarja Angela Merkel ka uruar ditë të qeta dhe të gëzueshme për festën e Kërshëndellave, si dhe shëndet, energji dhe besim për Vitin e Ri. "Uroj që viti 2020 të jetë një vit me të arritura dhe përplot paqe për ne të gjithë", ka shkruar kancelarja Merkel.
Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pranuar urime edhe nga presidenti i Republikës së Sllovenisë, Borut Pahor, si dhe nga presidentja e Kroacisë, Kolinda Grabar-Kitaroviq.
Edhe presidenti i Lituanisë, Gitanas Naus?da, i ka dërguar urim presidentit Thaçi, duke i uruar gjitha të mirat për festat e fundvitit.
Presidenti i Republikës së Kosovës ka pranuar edhe urime të tjera nga përfaqësues të shteteve të ndryshme, në të cilat urohet populli i Kosovës për festat e fundvitit.

## Fotolajm / NOSTALGJIA PËR EPOKËN

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Të hënën redaksinë e gazetës 'Epoka e re' e kanë vizituar dy ish-redaktorët, Demir Reshiti e Arsim Sinani të cilët për vite të tëra kanë kontribuuar për gazetën në vitet kur Epoka bënte epokën!



## Marrëveshje bashkëpunimi në mes të Komunës së Junikut dhe Universitetit të Gjakovës 'Fehmi Agani'

JUNIK, 23 DHJETOR (ER) - Komuna e Junikut dhe Universiteti i Gjakovës 'Fehmi Agani' kanë nënshkruar marrëveshje ndërinstitucionale për praktikë profesionale në drejtimet: Mjekësi, Filologji, Edukim dhe Shkenca Sociale. Marrëveshja e nënshkruar ndërmjet dy institucioneve thellon bashkëpunimin ndërinstitucional duke ofruar mundësi për praktikë profesionale për studentë dhe duke obliguar drejtoritë përkatëse që studentëve të komunës së tyre t'u ofrojnë kushte për mbajtjen e praktikës profesionale sipas profesioneve në afat prej 15 ditë pune për të gjitha drejtimet. Kryetari i Komunës së Junikut, Agron Kuçi, ka thënë që përpos përkrahjes paraprake për studentë përmes bursave do të vazhdojë angazhimi i tij si kryetar komune duke dhënë kontribut të përgatitjes akademike për studentë.



# Universiteti 'Ukshin Hoti' arrin marrëveshje bashkëpunimi me 'DokuFest'-in

PRIZREN, 23 DHJETOR (ER) - Universiteti "Ukshin Hoti" ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me Festivalin Ndërkombëtar të Filmit të Shkurtër dhe Dokumentar (DokuFest). Marrëveshja është nënshkruar të hënën në mes të rektorit të UPZ-së, prof. asoc. dr. Ismet Temaj dhe Linda Llula Gashi, drejtoreshë e "DokuFest"-it. Në thelb të marrëveshjes është bashkëpunimi në organizimin e përbashkët të shkollës verore ndërkombëtare në Prizren. Ndërkaq, në kuadër të kësaj marrëveshje, UPZ-ja pranon të shfaqë filma dokumentarë enkas për drejtimet e fakulteteve të UPZ-së, që do të bazohet në metodologjinë e "DokuFest"-it dhe në përputhshmëri të plotë me objektivat strategjike të arsimit të lartë në Kosovë, e që nxisin punën kërkimore-shkencore, artistike dhe inovacionit të universitet.

"DokuFest"-i dhe Universiteti "Ukshin Hoti" pajtohen që të bashkëpunojnë gjatë procesit të hartimit të programeve të caktuara studimore në kuadër të UPZ-së.

"DokuFest"-i dhe Universiteti "Ukshin Hoti" pajtohen që për nevoja të veta të shkëmbejnë ekspertë dhe përvojat e tyre në fushat e caktuara, që kanë kapacitete dy palët.

Nënshkrimi i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit është zgjerim i bashkëpunimit mes "DokuFest"-it dhe UPZ-së, të cilët kanë pasur bashkëpunim të frytshëm deri më tani, në kuadër të projektit "Prezantimi i qasjeve të reja në edukimin shoqëror II", i cili është realizuar me sukses bashkë me partnerët rajonalë dhe ndërkombëtarë.



Në takim ishin edhe prorektori për bashkëpunim ndërkombëtar dhe ngritje të cilësisë, prof. ass. dr. Soner Yildirim, dhe prof. ass. dr. Kushtrim Braha, i angazhuar për ngritjen e kapaciteteve të UPZ-së, i cili ka kontribuar edhe në konceptimin e shkollës verore ndërkombëtare të universitetit.

"DokuFest"-i, Festivali Ndërkombëtar i Dokumentarëve dhe Filmit të Shkurtër është festivali më i madh i filmit në Kosovë. Çdo vit festivali sjell kinematë dhe vendet e ekspozimit të ekranit, rreth qendrës historike të qytetit të Prizrenit një përzgjedhje prej më shumë se 200 filmave të zgjedhur me dorë nga e gjithë bota.

# Kryetari Latifi mbajti debatin e dytë publik me qytetarët

RAHOVEC, 23 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka mbajtur të hënën debatin e dytë publik me qytetarë për punën njëvjeçare të qeverisë komunale për vitin 2019. Në fillim të debatit, kryetari Latifi ka prezantuar, përmes videoprojektorit, raportin e punës për vitin 2019, projektet dhe të arriturat e qeverisë komunale, duke thënë gjatë këtij viti janë bërë investime në të gjitha fushat, me theks të veçantë aty ku ka pasur nevojë më shumë, aty edhe investimi është bërë me kohë. "Duhet cekur se komuna për herë të parë nga buxheti i vet i ka ndihmuar fermerët me mekanizëm bujqësor dhe stalla



të vogla. Sigurisht se ka shumë projekte që janë në realizim e sipër e të cilët ju çdo ditë edhe i shihni e të cilët janë në të mirë të të gjithë qytetarëve të komunës, pa ndonjë dallim. Projekte që janë në interes të qytetarëve bazuar edhe në kërkesat që i paraqitnojmë do të ketë edhe gjatë vitit 2020", ka thënë Latifi.

Qytetarët e pranishëm në debat falënderuan kryetarin Latifi për angazhimet e treguara në realizim të projekteve të shumta dhe për përkujdesjen e treguar gjatë gjithë vitit ndaj të gjithë qytetarëve të komunës dhe shtruan edhe disa pyetje. Të gjitha pyetjet e bëra nga qytetarët përgjigjet i kanë marrë nga kryetari i komunës, Smajl Latifi.

Në fund të debatit, kryetari u ka dhënë mirënjohje të gjithë kryetarëve të lagjeve dhe fshatrave, Kryqit të Kuq, Grupit Joformal të Grave, QKMF "Dr. Fahredin Hoti", ShL Kosova, ShPG Hareja në Rahovec dhe familje të cilat kanë strehuar familjarë të prekur nga tërmeti në Shqipëri, me motivacionin "Për kontributin dhe gatishmërinë tuaj ndaj qytetarëve që ju përfaqësoni dhe solidaritetin që treguat ndaj bashkëkombësve tanë të prekur nga tërmeti".

Gjithashtu, kryetari Latifi i ka informuar të pranishmit në debat se zyrtarët përgjegjës do të publikojnë në uebfaqe zyrtare raportin e punës së qeverisë komunale për vitin 2019 dhe se të hënën do të dalë në diskutim publik edhe Plani i punës së qeverisë komunale për vitin 2020. Për këtë fundit kryetari ka kërkuar që të japin vërejtje dhe sugjerime.

## Sot hapet Panairi i Turizmit në Prizren

Prizren, 23 dhjetor (ER) - Komuna e Prizrenit ka njoftuar se Drejtoria e Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik sot (martë) do ta organizojë Panairin e Turizmit, i cili do të mbahet në hapësirat e Kejit, përballë xhamisë së Sinan Pashës. Në këtë panair do të bëhet prezantimi i produkteve nga tour operatorët, bizneset hoteliere, guidat vendore dhe mysafirët e ftuar, ndërsa hapja do të bëhet në orën 12:00 nga ana e kryetarit të Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka. Në kuadër të këtij panairi organizohet edhe ekspozita e fotografive të vjetra të qytetit të Prizrenit në hamamin e Gazi Mehmet Pashës dhe konferenca "Gastronomia dhe turizmi" që do të mbahet në hotel "Theranda".



# Mustafa: LDK-ja në këto 30 vjet ishte udhëheqëse për liri, pavarësi dhe shtetndërtim

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka shënuar të hënën 30-vjetorin e themelimit të partisë. Kryetari i kësaj partie, Isa Mustafa, ka uruar popullin e Kosovës në shënimin e përvjetorit jubilar të LDK-së, por pati edhe porosi për kundërshtarët, duke thënë se LDK-ja ka qëndruar e fortë dhe ka dëshmuar se do t'i respektojë të gjitha gjeneratat. "LDK-ja është lidhja që rilindi Kosovën me guxim dhe mençuri, vendosmëri dhe vizion rilindës të presidentit tonë, Dr. Ibrahim Rugovës. LDK-ja në këto tri dekada ishte prijatare e pluralizmit jo vetëm ndërshqiptar. Në dekadën e parë ishte udhëheqëse e rrugëtimit të gjatë për liri; dekadën e dytë LDK-ja ishte prijëse e përpjekjeve për pavarësi dhe në dekadën e tretë, shtyllë e shtetndërtimit. Prej sot që po fillon dekada e katërt, LDK-ja është adresë e zhvillimit të projektit të Kosovës si shtet i pavarur, njohur nga bota demokratike. Ibrahim Rugova ka qenë kryetar i saj gjatë gjithë jetës së tij. Rugova me politikën e urtë dhe vizionare e bëri LDK-në forcën më të madhe të integrimit dhe krijoi miq anekënd botës", ka thënë Mustafa, duke shtuar se LDK-ja për 30 vjet u ka shërbyer qytetarëve të Kosovës.

Ai ka përmendur se kësaj partie i duhet uniteti, duke përmendur ndarjen që partia kishte pësuar në vitin 2006 si luftë për pushtet brenda saj. "Kishim një fatkeqësi politike në Kuvendin e vitit 2006, ku LDK-ja u nda në dy pjesë për shkak të luftës për pushtet brenda partisë në vend të 47 deputetëve. Nga partia e parë atëherë ramë në partinë e dytë në fillim të vitit 2007. Kjo është dëshmia më e mirë që LDK-ja ka nevojë për unitet dhe




ambiciet personale t'i kalojmë ndryshe e jo përmes përçarjeve brenda subjektit tonë", ka thënë Mustafa.

Lideri i LDK-së ka theksuar se partia që drejton ka ndërmarrë veprime për të krijuar hapësirë për njerëz të rinj. "Në zgjedhjet 2017-s me z. Hoti dhe në këto zgjedhje me Vjosa Osmanin", ka thënë Mustafa.

Për këtë 30-vjetor të themelimit LDK-ja ka marrë urime nga Lëvizja Vetëvendosja, Aleanca Kosova e Re, Partia Demokratike në Shqipëri dhe Partia për Veprim Demokratik në Preshevë.

# Përurohet qendra e parë e trajtimit të sulmeve në tru

EPOKA E RE Faton DËRMAKU




PRISHTINË, 23 DHJETOR - Ministri në detyrë i Shëndetësisë (MSh), Uran Ismaili, ka përuruar të hënën në QKUK qendrën e parë nacionale që trajton sulmin në tru, në Klinikën e rinovuar të Neurologjisë. Ministri Ismaili ka thënë se me hapjen e kësaj qendre po krijohen kushte që të shpëtohen qytetarët nga vdekja, paraliza dhe shpenzimet e larta financiare. "Është një datë e rëndësishme për pacientët në Kosovë. Duke e ditur se sulmi në tru shkakton vdekje dhe invaliditet të lartë, por edhe ka pasur nevojë që të kemi një qendër që mund të reagojë në orët e para. E shohim një hapësirë moderne me aparaturë moderne dhe mjekë të përgatitur", ka thënë ai. Ismaili ka theksuar më tej se "kemi një qendër e cila do të shpëtojë jetë dhe njëkohësisht do të shpëtojë edhe xhepin e pacientëve".

Pas shërbimit 24 orësh për trajtimin e zemrës, si shkaktari kryesor i vdekjeve, theksoi më tej ministri, me hapjen e qendrës së parë nacionale në Kosovë për trajtimin e sulmeve në tru, po krijohen kushte të trajtohet edhe shkaktari i dytë kryesor i vdekjeve në vend. Ai ka thënë se me pajisjet dhe infrastrukturën e kësaj qendre mundësohet një reagim i shpejtë brenda tri orëve.

Drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ka thënë se në klinikën e përuruar do të kryhet trajtimi i infarktit të trurin me metoda moderne. "Është një datë historike për shëndetësinë kosovare. Do të bëhet trajtimi i infarktit në tru me metoda inovazive ashtu siç ka qenë projekt nacional trajtimi i infarktit në zemër. Është i mirëpritur, sidomos për pacientët. Në orët e para do të mund të shpëtohen jetë dhe largimi nga invaliditeti. Kemi pasur shumë pacientë që janë mbajtës të familjeve. Pacientët që janë në fazën më të re mund të vijnë në orët e para. E kemi ekipin dhe stafin e përgatitur. Janë trajnuar në Kroaci. Tani praktikën mund ta zbatojnë në QKUK", ka deklaruar Sejdiu.

Drejtori i Klinikës së Neurologjisë, Nexhmedin Shala, ka falënderuar ministrinë e Shëndetësisë për investimin në këtë klinikë e cila do t'i shpëtojë jetët e pacientëve. Në Kosovë 1 200 deri në 1 300 pacientë shtrohen për mjekim brenda një viti nga disa lloje të sulmit në tru. Shkalla e vdekshmërisë prej sulmeve në tru është e madhe, mund të shkojë deri në 40 për qind. Investimet në krijimin e qendrës për trajtimin e sulmeve në tru ka kushtuar rreth 200 mijë euro, kurse pajisjet 1.1 milion euro.

## Mbahet takimi i radhës i grupit punues kundër krimit të organizuar

PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme të hënën është mbajtur takimi i radhës i Grupit Punues kundër krimit të organizuar. Takimin e hapi koordinatori Nacional Kundër Krimit të Organizuar, njëherësh zëvendësministër i Punëve të Brendshme, Selami Shkodra.

Në këtë takim u diskutua për aktivitetet që janë ndërmarrë në luftën kundër kësaj dukurie dhe për përpjekjet maksimale në luftimin e të gjitha llojeve të krimit në Kosovë. Zëvendësministri Shkodra ka thënë se nuk do të duhej të ketë vakum institucional dhe i ka inkurajuar institucionet e vendit të vazhdojnë me përkushtim të shtuar në këtë drejtim.

Në këtë takim u diskutua raporti përmbledhës vjetor K2 dhe K3 si dhe u vendos të bëhet vlerësimi i Planit të Veprimit të Strategjisë kundër Krimit të Organizuar në muajin shkurt të vitit 2020.



# Klubi i Prodhuesve, mik i fëmijëve për vitin 2019



PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Klubit të Prodhuesve të Kosovës i është ndarë çmimi "Mik i fëmijëve" nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë - KOMF, për kontributin e çmuar në shërbime sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë.

Klubi i Prodhuesve është shpërblyer me këtë çmim për angazhimin dhe kontributin për mbrojtjen dhe zhvillimin e fëmijëve përmes projekteve që i ka ndërmarrë në bashkëpunim me SOS Fshatrat e Fëmijëve. "Projekte këto që kanë qenë mjaft inovative e të cilat mbështesin zhvillimin social dhe edukativ të fëmijëve dhe që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien e tyre. Si projekt shumë i rëndësishëm është Punëtoria Made in Kosova, e cila ka për qëllim edukimin, ndërgjegjësimin dhe socializimin e fëmijëve. Por edhe për organizimin e gala mbrëmjes humanitare për SOS Fshatrat e Fëmijëve, për mbledhjen e fondeve me të cilat ndihmohen fëmijët pa përkujdesje prindërore, të braktisur dhe fëmijët në rrezik të humbjes së kujdesit prindëror. Gjithashtu, edhe për mbështetjen e kampanjës '#Iseeyou', me qëllim të ndikimit në shoqëri dhe kontributit për mbrojtjen e fëmijëve në Kosovë", është bërë me dije në njoftimin e Klubit të Prodhuesve.

Më tej, është theksuar se Klubi i Prodhuesve do të jetë gjithmonë një mik dhe mbështetës i të ardhmes së këtij vendi. "Pra, i të gjithë fëmijëve, duke besuar që nëse i motivojmë dhe i inkurajojmë ata, e ardhmja do të jetë gjithmonë e sigurt", thuhet në këtë njoftim për media.

# ATK-ja zotohet për trajtim të barabartë të tatimpaguesve

PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) do të vazhdojë të kontribuojë në mjedisin e të bërit biznes, duke u fokusuar trajtim të barabartë tatimpaguesve dhe duke e vazhduar bashkëpunimin e ndërsjellë me Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë. Kjo u tha të hënën gjatë një takimi të anëtarëve të Odës Amerikane me drejtorin e përgjithshëm të Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj.

Drejtori ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane, Arian Zeka, ka thënë se është për t'u përgëzuar qasja e Administratës Tatimore, e cila edhe në rrethana të tilla të sfiduara politikisht pas dorëheqjes së qeverisë, vazhdon ta kryejë punën në mënyrë korrekte si institucion i pavarur ekzekutiv. Ai ka theksuar se Oda Amerikane mbetet e përkushtuar për vazhdimin e bashkëpunimit me ATK-në si një ndër institucionet më të rëndësishme për punën e bizneseve.

Ndërkaq drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, ka përmendur zhvillimet e shumta të ATK-së në 20 vjetët e fundit, ku ka theksuar faktin se ky institucion, në krahasim me vitet paraprake, ka avancuar në shumë procese, me qëllim të trajtimit të barabartë për të gjitha bizneset. Si shembull për këtë ai ka përmendur rritjen e efikasitetit në procesin e grumbullimit të të hyrave, mbledhjes së borxheve, si dhe reformat në shqyrtimin e kërkesave të tatimpaguesve.




Murtezaj ka shtuar se, përkundër këtyre zhvillimeve, ka shumë çështje për të cilat ekziston hapësirë për përmirësime dhe se ATK-ja është e hapur për rekomandime. Ai ka folur edhe për masat e ndërmarra për rritjen e integritetit të zyrtarëve tatimorë, për çka po marrin mbështetje edhe nga programet e organizatave ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe Agjencinë e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar.

Gjatë këtij takimi anëtarët e Odës Amerikane patën mundësi të ngritin çështje të ndryshme dhe të marrin përgjigje nga përfaqësuesit e ATK-së, njëkohësisht duke ofruar rekomandimet e tyre për Administratën Tatimore të Kosovës, me theks të veçantë në nevojën e luftimit të ekonomisë joformale.

## 81 për qind e ndërmarrjeve në Kosovë përdorin mediat sociale




PRISHTINË, 23 DHJETOR (ER) - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka përgatitur për herë të parë publikimin me të dhëna për përdorimin e teknologjisë informative dhe komunikimit në ndërmarrje për vitin 2018. Në vitin 2019, Departamenti i Statistikave Ekonomike pranë ASK-së e ka zhvilluar për herë të parë anketën e përdorimit të teknologjisë informative dhe komunikimit në ndërmarrje sipas metodologjisë së Eurostatit. Anketa është zhvilluar në territorin e Republikës së Kosovës në ndërmarrjet me 10 e më shumë të punësuar.

Përmes këtij publikimi janë prezantuar të dhënat si në vijim: sipas rezultateve në nivel të anketës, ndërmarrjet që kanë përdorur kompjuterin për qëllime punë gjatë vitit 2018 përfaqësojnë 98.6 për qind të ndërmarrjeve. Sipas rezultateve në nivel të anketës, 97.1 për qind e ndërmarrjeve kanë përdorur internetin për qëllime pune gjatë vitit 2018. Nga ndërmarrjet e anketuara, 63.1 për qind prej tyre kanë uebfaqe të ndërmarrjes, ndërsa 81.3 për qind e ndërmarrjeve i përdorin mediat sociale.

Nga ndërmarrjet e anketuara 11.4 për qind prej tyre kanë realizuar shitje përmes uebfaqes ose ndonjë aplikacioni tjetër përmes kompjuterit. Ndërsa 19 për qind prej tyre kanë realizuar blerje përmes uebfaqes ose ndonjë aplikacioni tjetër përmes kompjuterit.

# Mehmeti: Rritja ekonomike për këtë vit vlerësohet të jetë 4.2 për qind

Në konferencën përmbyllëse për këtë vit me gazetarë, guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka bërë me dije se, bazuar në vlerësimet preliminare, rritja ekonomike për vitin 2019 pritet të jetë rreth 4.2 për qind, rritje kjo e mbështetur kryesisht nga rritja e investimeve dhe përmirësimet në eksportet neto. "Ritëm i ngjashëm i rritjes ekonomike, sipas parashikimeve të BQK-së, pritet edhe në vitin e ardhshëm", ka thënë Mehmeti




EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Fehmi Mehmeti, ka thënë se gjatë vitit 2019 sektorët që i ka nën përgjegjësi BQK-ja kanë performuar mirë. Në konferencën përmbyllëse me gazetarë, guvernatori Mehmeti ka bërë me dije se sektori bankar edhe këtë vit vazhdoi me rritje të lartë të kreditimit, përmirësim të kushteve për qasje të sektorit privat në kredi si dhe me rritje të qëndrueshmërisë financiare.

Sipas guvernatorit Mehmeti, deri në fund të tetorit 2019 kreditë e sektorit bankar kanë arritur vlerën prej 2.98 miliardë eurosh.

Rritja vjetore e kredive mbetet e lartë, me normë vjetore prej 10 përqindësh, përderisa burime kryesore të financimit të aktivitetit të sektorit bankar vazhdojnë të jenë depozitat, shuma e të cilave gjatë kësaj periudhe arriti në 3.75 miliardë euro, që paraqet një rritje vjetore mjaft të lartë prej 16 përqindësh. "Normat e interesit në kredi vazhduan trendin rënës, duke zbritur në 6.5 për qind nga 6.6 për qind sa ishin në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, që reflekton përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të tregut dhe lehtësimin e qasjes në financim bankar. Vlen të theksohet posaçërisht cilësia shumë e mirë e portofolit kreditor me një normë të kredive joperformuese prej vetëm 2.1 përqindësh në tetor 2019, e cila shënoi rënie të mëtutjeshme në krahasim me vitin e kaluar kur ishte 2.7 për qind. Me zhvillime të favorshme u karakterizua edhe sektori i fondeve pensionale. Vlera e aseteve të sektorit pensional në shtator 2019 arriti në 1.92 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 8.8 përqindësh", ka thënë ai.

Mehmeti ka thënë se kthimi nga investimet e fondeve pensionale ishte mjaft i kënaqshëm, ku gjatë periudhës janar-shtator u investuan 138 milionë euro, që tregon për rritje të vlerës së kursimeve pensionale të qytetarëve. "Një sektor tjetër i rëndësishëm i sistemit financiar është sektori i institucioneve mikrofinanciare dhe institucioneve jobankare, i cili po vazhdon ta përshpejtojë ritmin e kreditimit. Gjithsej vlera e kredive të këtij sektori në tetor 2019 arriti në 217.1 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 22.2 përqindësh. Gjatë këtij viti normat e interesit efektiv janë zvogëluar nga 23.1 për qind në 20.3 për qind. Sektori i sigurimeve vazhdoi ta rrisë aktivitetin sigurues si dhe kompensimin e dëmeve për të siguruarit. Gjithsej vlera e shkruar e primeve nga kompanitë e sigurimeve deri në shtator 2019 ishte 74 milionë euro, e cila paraqet një rritje vjetore prej 7.1 përqindësh", ka bërë me dije guvernatori Mehmeti. Ai ka shtuar se vlera e dëmeve të paguara arriti në 37.9 milionë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 7.3 përqindësh. Mehmeti ka thënë se BQK-ja po angazhohet për të siguruar trajtim korrekt të dëmeve nga kompanitë e sigurimeve.

Guvernatori Mehmeti ka përmendur edhe vendimet e marra nga BQK-ja me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar në vend. "Me qëllim të sigurimit të stabilitetit financiar dhe si pasojë e mospërputhjes me kërkesat rregullative dhe mosrespektimit të masave përmirësuese të BQK-së, në vitin 2019, në rolin e saj prej rregullatores dhe mbikëqyrëses së institucioneve financiare, BQK-ja i ka revokuar licencën kompanisë 'Insig' Sh.A., Dega Kosovë. Gjithashtu, me qëllim të mbrojtjes së palëve të dëmtuara prej të siguruarve nga autopërgjegjësia dhe krijimit të kushteve të nevojshme për zhvillim të qëndrueshëm të sektori të sigurimeve, BQK-ja ka përshtatur tarifat e kategorisë I për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia ndaj palës së tretë të cilat ishin të pandryshuara që nga viti 2001. Pak kohë më parë, siç edhe jeni të njoftuar, BQK-ja ka revokuar licencat për dy institucionet: IMF 'IuteCreditKosovo' Sh. A. dhe për IFJB 'Monego', të cilat gjatë viteve të operimit në tregun tonë në vazhdimësi kanë devijuar nga planet e tyre të biznesit në bazë të të cilave kishin marrë licencat për të operuar në Kosovë, duke i sjellë kështu tregut tonë diçka tjetër prej asaj që kishin premtuar që do të sjellin", është shprehur ai.

Lidhur me këtë proces, guvernatori ka pohuar se janë duke vërejtur forma të ndryshme të presionit publik ndaj këtyre vendimeve. "Dëshirojmë të ritheksojmë se BQK-ja ka vepruar në përputhje të plotë me mandatin ligjor dhe jemi të bindur se veprimi ynë është i drejtë, prandaj asnjë formë e presionit publik nuk mund të çojë në rishikimin e këtyre vendimeve", ka thënë Mehmeti. Ai ka pohuar se BQK-ja vazhdon të veprojë në funksion të mbështetjes së zhvillimit të qëndrueshëm të sistemit financiar, duke siguruar infrastrukturën e nevojshme ligjore për ta mbështetur zhvillimin e institucioneve financiare dhe në të njëjtën kohë duke u siguruar stabilitet financiar. "Harmonizimi i kornizës rregullatore me zhvillimet e fundit ndërkombëtar në këtë fushë, më konkretisht në Bashkimin Evropian, ka vazhduar të jetë prioritet i rëndësishëm i BQK-së edhe gjatë këtij viti, me ç'rast janë përpiluar rregullore të ndryshme të cilat avancojnë aspekte të ndryshme të rregullativës bankare, në veçanti atë të qeverisjes korporative të bankave", është shprehur ai.

Mehmeti ka theksuar se këtë vit BQK-ja ka avancuar programet e edukimit financiar dhe ka aplikuar masa korrektuese ndaj institucioneve financiare me qëllim të mbrojtjes së konsumatorëve.

Guvernatori Mehmeti ka bërë me dije se bazuar në vlerësimet preliminare, rritja ekonomike për vitin 2019 pritet të jetë rreth 4.2 për qind, rritje kjo e mbështetur kryesisht nga rritja e investimeve dhe përmirësimeve në eksportet neto. "Ritëm i ngjashëm i rritjes ekonomike, sipas parashikimeve të BQK-së, pritet edhe në vitin e ardhshëm. Norma mesatare e inflacionit vjetor deri në nëntor 2019 është rritur për 2.8 për qind, në krahasim me normën prej 0.9 përqindësh në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rritja e normës së inflacionit gjatë këtij viti kryesisht është rezultat i rritjes së çmimeve të ushqimit", ka thënë Mehmeti.

Kosova e pasluftës (2)

# Lufta dhe rivaliteti i brendshëm në Kosovë



Shkruan: Izmi ZEKA

Periudha pas shpalljes së pavarësisë sikur ndërroi qasjen ndaj shtetit dhe zhvillimit të saj. Tanimë institucionet shtetërore drejtoheshin në mënyrë autonome në qeverisjen e vendit, në përjashtim që disa të drejta u morën apo vazhduan nga EULEX-i që kishin të bënin me sundimin e ligjit në Kosovë.
Edhe ky mision, mbase evropian, përmes gjykatësve të vet filloi të shpallë aktakuza prej më të ndryshmeve, por në fund të gjitha rezultonin të pabazuara në fakte dhe në ligj. Pjesë tjetër që bën punën e djallit ishin edhe disa portale që Zoti e di prej nga financoheshin duke i dhënë kah denigrues secilës së arritur në Kosovë.
Një problem në vete që mbeti ende enigmë ishte fati i të vrarëve pasluftës e ku për drejtim te gishtit kishin partitë të cilat kishin dalë prej luftës.
Fatkeqësisht, me varret e tyre ende të pandriçuara në Kosovë luhej dhe përdorej gjatë fushatave elektorale duke krijuar paragjykime, por edhe duke mos u zbardhur kurrë fati i tyre.
Këto që u përmendën më lart bën që Kosova dhe institucionet e saj të mbetën peng i moszhvillimit dhe prosperimit të saj.
Lufta dhe rivaliteti i brendshëm kosovar ka bërë që për vite të tëra Kosova ta humbë fuqinë diplomatike të saj në raport me Serbinë, por edhe përfaqësimin dinjitoz në arenën ndërkombëtare. Mbase edhe lojëra të padurueshme të BE-së në raport me Kosovën dhe përkëdheljen e shtetit serb kanë bërë që hapat zhvillimorë të mbetën në vendnumërim dhe për pasojë pati pakënaqësi nga qytetarët.
Kush më mirë se Faik Konica i portretizon shqiptarët: "Shqiptarët janë një komb që i pëlqen të lëvdojë veten. Si thonë gojë-rrumbullët tanë, kombi shqiptar është i pari nga mendja, nga të sjellurit e nga trimëria. Mua më duket se një njeri që i ka trutë në vend nuk duhet të flasë në atë mënyrë. Po të ishte ashtu… shqiptarët do të kishin dalë me kohë nga dita e zezë ku ndodhen". E thënë herët dhe pa ekuivokë.
Ndoshta ne kemi dashur që gjithë historinë ta bëjmë me kaçak mali por kurrë assesi në një vertikale dhe hierarki në organizimin luftarak. Për ilustrimin tonë, faktet historike dëshmojnë se lufta e brendshme politike i ka rrënjët më herët se që mendohet.
Edhe në fillimet e shekullit XX dhe gjysmën e parë të këtij shekulli ndodhën rrebesh shtyrjesh që po të studiohet mirë fundi ishte shkatërrim i vetvetes.
Kush e bëri vrasjen e Avni Rrustemit, Hasan Prishtinës, Luigj Gurakuqit, Bajram Currit e shumë të tjerëve.
Ky është figurativisht defekti historik që ne tani trashëguam në mënyrë të "denjë" këtë virtyt që pengoi lindjen dhe bashkimin e shqiptarëve në një shtet.
Tani kur po shkruaj disa gjëra që besoj do t'i tregojë dhe argumentojë e ardhmja, Kosova ka përballje me vetveten e jo siç po deklarohet me Serbinë.
Ky shtet gjenocidial i përket të kaluarës por ndikimi i tij ende është i madh dhe jo vetëm kaq, por shërbime dhe njerëz të ndryshëm ende bëjnë punën jo vetëm të Serbisë por edhe të Rusisë dhe shteteve që historikisht ishin dhe janë kundër Kosovës dhe shqiptarëve në përgjithësi.
Përballja me ata të cilët edhe dje ishin kundër ndryshimit dhe prerjes historike po vazhdon. Edhe mund të kuptohet për disa arsye, por më e veçanta është se duke e ndjerë vetën fajtor për mosreflektim në momente historike tani duan që pashmangshëm duke atakuar individë të kthesave të arrijnë ambiciet e tyre personale dhe familjare.
Mund dhe duhet të kemi dallime të brendshme por jo në skajshmëri për të satanizuar historinë tonë të lavdishme të fund shekullit XX. Në emër të vjedhjes së shtetit, në emër të shitjes së shtetit dhe "tradhtisë "kombëtare" Kosovën e demonizuan dhe duan ta kthejnë në një shtet të padobishëm dhe pa perspektivë.
Me habit fakti se si është arritur të bëhet shpëlarja e trurit dhe ata që e sollën lirinë po dëshirojnë ta shesin Kosovën, kurse ata të cilët edhe para luftës dhe pas saj nuk iu kishte munguar asnjë fije floku tani shesin patriotizëm me kile.
Një ilustrim se deri në cilën shkallë kemi arritur e sheh gjatë proceseve historike ku po citoj një thënie të Faik Konicës Në një intervistë në "Universul" më 10 janar 1914, Faik Konica, e akuzon Ismail Qemailin për korrupsion e madje edhe për tradhti. Ai shton se "Ismail Bej Qemali, një 'fileu' bizantin, i korruptuar nga shpirti dhe nga zakonet, pa ideal dhe pa parime, i gatshëm për të gjitha kompromiset".
Ky ka qenë mentaliteti edhe i figurave të mëdha qoftë të historisë, letërsisë ku nga ky rezon të kuptuarit e kohës ishte jashtë tablloidit të tyre.
Ismail beu dje dhe sot është prej figurave më të rëndësishme të historisë shqiptare.
Aso kohe ishte harruar se Shqipëria ishte pre e fuqive të mëdha dhe në prag të fillimit të Luftës së Parë Botërore.
Çfarë koincidence e kohës së sotme me fillimet e shekullit XX.
Jo rastësisht veçova një fjali për të arritur në përfundim se lufta dhe mentaliteti i ynë gjatë gjithë historisë nuk kanë korresponduar me realitetin në fjalë.
Ndjenja për të qenë protagonist të kohës duke shpërfaqur mani dhe luftë brenda llojit, ka bërë që vrasjet e tmerrshme, masakrat të mbetën nën hijen e shterpësisë politike. Akterët të cilët tani më janë edhe të njohur të regjimit serb dhe udhëheqin me politikat shtetërore serbe shëtisin të lirë pa u ndëshkuar fare.
Një pjesë të fajit e bartin institucionet tona por edhe mekanizmat ndërkombëtar të cilët në emër të stabilitetit dhe pajtimit shkelën mbi parimet demokratike dhe të drejtat njerëzore të një populli.
U munduan të bëjnë balancim në mes të atyre që bënë masakra dhe atyre që ruajtën shtëpitë e tyre. Nga ky vlerësim mund të konkludojmë se drejtësia e udhëhequr nga UNMIK-u e pastaj nga EULEX-i ishte drejtësi selektive dhe joparimore, e cila tani ka sjellë mosbesim qoftë edhe në institucionet më kredibile që mund të formohen, qoftë tek ne apo edhe tek ndonjë mekanizëm ndërkombëtar.
Kjo ishte vetëm një pjesë e historisë së drejtësisë ndërkombëtare në Kosovë.
Kosova e pas pavarësisë pati një ritëm të zhvillimit dhe stabilitetit institucional deri diku kah vitet 2013 e që u krijuan parakushte për një shtet të së drejtës.
Pas kësaj kohe kemi kthim mbrapa në krijimin e një politike zhvillimore të bazuar në standardet që i kërkonte koha.

**(Vijon)**

# USAID-i: Gjilani, komuna që ka pasur ngritjen më të madhe në procesin e gradimit

**Gjilan, 23 dhjetor (ER)** - Kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka pritur në takim drejtorin e programit Komunat Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM), Stephen Carpenter, ku edhe zyrtarisht është bërë transferimi i pajisjeve dhe inventarit nga projekti i realizuar muaj më parë për Komunën e Gjilanit. Haziri ka falënderuar drejtorin Carpenter për mbështetjen e jashtëzakonshme për Gjilanin në fushën e prokurimit, financave, auditimit, personelit në Zyrën e Informimit, për ngritjen e kapaciteteve dhe mbështetjen e madhe me anë të pajisjeve dhe inventarit të ofruar.
Edhe drejtori i programit



Komunat Transparente, Efektive dhe Llogaridhënëse (USAID TEAM), Stephen Carpenter, ka falënderuar kryetarin Haziri për bashkëpunimin e mirë, ndërsa ka lavdëruar Gjilanin për përparimin e madh në shumë fusha. "Ka qenë kënaqësi të bashkëpunojmë me kryetarin Lutfi Haziri dhe zyrtarët e tjerë të komunës dhe jam i lumtur që Gjilani ka ecur shumë përpara brenda tre vjetëve. Pra, është komuna që më së shumti ka përparuar në fushën e gradimit, nga 44 pikë sa ka qenë në fillim, ka arritur në 67 pikë", ka thënë ai.
Takimi në mes të Hazirit dhe Carpenterit ka qenë lamtumirës për drejtorin e këtij programi pasi ai përfundon mandatin në këtë pozitë.
Projekti TEAM është projekt pesëvjeçar i financuar nga USAID-i që ka filluar më 11 janar 2017 dhe është planifikuar të përfundojë në janar 2022.
Projekti është i dizajnuar që ta përmirësojë drejtësinë, transparencën dhe mbikëqyrjen e prokurimit duke ofruar asistencë të plotë në të gjitha 38 komunat e Kosovës, me theks të veçantë në pesë komunat që janë në fokus të projektit përmes mentorimit, trajnimit dhe stërvitjes për ta përmirësuar llogaridhënien për fondet dhe shpenzimet publike.

## Putini inauguron linjën hekurudhore Rusi-Krime

MOSKË, 23 DHJETOR - Presidenti rus, Vladimir Putin ka marrë pjesë të hënën në ceremoninë e hapjes zyrtare të urës që lidh Rusinë me Gadishullin e Krimesë, të pushtuar nga Rusia.
Kievi, Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë dënuar ndërtimet e nisura nga Rusia, duke i konsideruar si shkelje të sovranitetit të Ukrainës, andaj fuqitë botërore kanë vënë sanksione në kompanitë e lidhura me ndërtimin e urës 19-kilometërshe.
Putini në anën tjetër ka falënderuar punëtorët për përpjekjet e tyre për të ndërtuar "këtë projekt gjigant", në një ceremoni të transmetuar drejtpërdrejt në televizionin shtetëror rus.
Në muajin nëntor, kompania private hekurudhore, Grand Service Express ka njoftuar se treni i parë do të nisej nga Shën Petersburgu për në Sevastopol më 23 dhjetor dhe do të udhëtojë, 2,741 kilometra për 43 orë e gjysmë.
Kjo urë ka kushtuar 3.7 miliardë dollarë dhe është ura më e gjatë në Evropë, duke tejkaluar urën Vasco de Gama të Portugalisë.
Pjesa hekurudhore e inauguruar sot është shtesë e hapësirës së ndarë për makina të hapur në maj të vitit të kaluar.
Krimea është e lidhur vetëm me Ukrainën, andaj për ta lidhur atë me Rusinë është nevojitur një urë.
Departamenti amerikan i Shtetit ka dënuar ndërtimin e urës, duke thënë se është bërë "pa lejen e Qeverisë së Ukrainës".
Rusia ka aneksuar Gadishullin e Krimesë nga Ukraina më 2014. Ky aneksim nuk është njohur nga komuniteti ndërkombëtar.
Rusia, po ashtu, ka mbështetur luftëtarët separatistë në luftimin e forcave të Kievit në lindje të Ukrainës, në një luftë që ka lënë të vrarë më shumë se 13,000 persona nga viti 2014.



# NATO-ja kthen vëmendjen te sfida që paraqet Kina

**Ekspertët argumentojnë se Pekini po synon ta sundojë industrinë e teknologjisë së lartë në botë përmes gjigantit të vet të teknologjisë "Huawei", të krijojë një ushtri të fortë sikurse ajo e ShBA-së si dhe ta lidhë shumicën e popullatës botërore me projektin e vet infrastrukturor "një brez një rrugë"**



BRUKSEL, 23 DHJETOR - Një numër i madh ekspertësh thonë se lajmi më i rëndësishëm i takimit të NATO-s të mbajtur së fundmi në Londër ishte se aleanca më e qëndrueshme dhe më efektive në histori botërore për herë të parë përcakton Kinën si një sfidë strategjike. Ata argumentojnë se Pekini po synon ta sundojë industrinë e teknologjisë së lartë në botë përmes gjigantit të vet të teknologjisë "Huawei", të krijojë një ushtri të fortë sikurse ajo e Shteteve të Bashkuara si dhe ta lidhë shumicën e popullatës botërore me projektin e saj infrastrukturor "një brez një rrugë", ka njoftuar voa.
"Diskutimet në takimin e NATO-s në Londër u përqendruan te njohja e faktit se Pekini është një konkurrent i rrezikshëm botëror për aleancën, më i shkathët dhe më i fuqishëm krahasuar dhe me ish-Bashkimin Sovjetik", thotë ish-komandanti i lartë ushtarak i NATO-s gjenerali në pension James Jones.
"Qëllimi strategjik i Kinës është të sundojë jo vetëm popullin e vet, por t'i shtrijë duart kudo të mundet në pjesën tjetër të botës. Dhe këtë po e bën me shumë aftësi, duke depërtuar dhe investuar në ekonomitë e vendeve tona, duke përdorur teknika pothuajse kapitaliste. Por në të njëjtën kohë duke zhvilluar spiunazhin kibernetik si dhe vjedhur pronën intelektuale me një efektivitet të pashembullt", thotë ai.
Kina synon të ndërtojë infrastrukturën digjitale të shekullit 21, me ndihmën e gjigantit të saj në fushën e teknologjisë "Huawei".
Jones parashikon se Kina do ta shfrytëzojë pozicionin e saj për të fituar avantazh ndaj Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve të saj.
"Një organizatë si NATO-ja duhet të ketë një sistem të sigurt në mënyrë që të funksionojë. Nuk mund të ketë 10 vende me 'Huawei' dhe 20 vende me diçka tjetër. Arsyeja pse e trajtoj këtë çështje me shumë pasion është sepse problemi është aktual po ndodh tani dhe jo pas 10 vitesh", thotë ai.
Sipas Jones gara për epërsi në sistemin 5G është po aq e rëndësishme sa ishte ajo për të prodhuar bombën e parë atomike apo e çuarjes së njeriut të parë në Hënë. "Kina është një fuqi në rritje. Popullsia e saj është 4 herë më e madhe sesa e Shteteve të Bashkuara. Ka një klasë të mesme që është më e madhe sesa e gjithë popullata amerikane. Ka shënuar arritje të jashtëzakonshme me tërheqjen e investimeve e teknologjisë të huaj", thotë gjenerali Wesley Clark, ish-komandant i lartë i NATO-s.
Për të minimizuar rreziqet, NATO-ja duhet të hartojë një plan për t'u mbrojtur kundër përpjekjes së Kinës për epërsi botërore, thotë Clark. "Nuk sjell asgjë të mirë fakti që Shtetet e Bashkuara i bëjnë presion Kinës në lidhje me teknologjinë dhe më pas Gjermania, Franca ose ndonjë aleat tjetër i NATO-s i shesin teknologji Kinës. Kjo është sfida jonë. Ne duhet të punojmë me aleatët tanë për t'u përballur me Kinën. Nëse e bëjmë këtë mund ta menaxhojmë sfidën që paraqet Kina", shton ai.
Thirrja e Uashingtonit për përqendrim më të madh te Pekini ka tërhequr vëmendjen e pjesës më të madhe të Evropës, ku po rritet shqetësimi rreth avantazhit në rritje ekonomik, ushtarak e teknologjik të Kinës.
"Për herë të parë, ne adresuam çështjen e gjallërimit të Kinës, si sfidat ashtu edhe mundësitë që paraqet, por dhe ndërlikimet ndaj sigurisë sonë. Udhëheqësit pajtohen që ne duhet ta adresojmë këtë çështje së bashku, si aleancë", thotë Jens Stoltenberg, sekretari i përgjithshëm i NATO-s.
Aleanca e Atlantikut të Veriut, prej 29-anëtarësh e cila festoi 70-vjetorin e saj në fillim të muajit dhjetor, përfaqëson gjysmën e fuqisë ekonomike e ushtarake në botë.

## Protestuesit në Francë përleshen me policinë

PARIS, 23 DHJETOR - Protestuesit francezë dhe policia u përleshën të hënën në stacionin e trenave Gare de Lyon të Parisit, ndërsa një grevë kombëtare hyri në ditën e 19-të.
Protestuesit po sfidojnë planet e presidentit Emmanuel Macron për të reformuar sistemin e pensioneve të Francës, që do t'i eliminonte pensionet e veçanta për shumë pjesëtarë të sektorit publik dhe rritjen e moshës së pensionit në 64 vjeç.
Policia e ndërhyrjes së shpejtë u përlesh me një grup prej afro 30 protestuesish, në një nga stacionet hekurudhore më të ngarkuara të kryeqytetit francez.
Greva ka prekur edhe stacione të tjera, si Gare du Nord, ku kalojnë trenat e Eurostarit për në Londër dhe Bruksel dhe Gare de l'Est.
Greva kombëtare e ka paralizuar rrjetin e transportit të Francës këtë sezon të Krishtlindjes, ndërsa punonjësit e sektorit të naftës pritet të vendosin që të mbyllen rafineritë e naftës si pjesë e protestës.



Eshaloni i UÇK-së në luftë me forcat armike të pritës dhe dimrin e acartë në Pashtrik (14)

# EPILOGU I PËRGJITHSHËM PËR LUFTËN E PASHTRIKUT



LULZIM SAHITI

Nga 143 ushtarë pjesëmarrës në eshalonin e UÇK-së, 41 prej tyre kanë rënë dëshmorë, 9 janë zënë rob, 42 janë ndarë në nëntë grupe të vogla që kanë arritur veç e veç të depërtojnë në brendi të territorit të Kosovës, kurse 51 të tjerë të ndarë në dy grupe janë rikthyer në Shqipëri. Prej 102 ushtarëve, 15 prej tyre kanë mbetur të plagosur nga armët e zjarrit dhe ciflat e predhave armike, ndërsa pjesa tjetër e ushtarëve, për shkak të qëndrimit të gjatë në natyrë, në temperatura ekstrem të ulëta të dimrit janë mërdhirë, kryesisht në pjesët periferike të trupit siç janë: hunda, veshët, gishtërinjtë, duart dhe shputate këmbëve.

Gjatë luftimeve krejtësisht të pabarabarta, më 14 dhjetor 1998 kanë rënë dëshmorë 41 pjesëtarë të radhëve të UÇK-së duke flijuar jetën për idealin e lirisë së Kosovës:

1. Afrim Islam Musliu (27) nga Belinci (Shtime)
2. Arben Rexhep Hyseni (18) nga Godanci i Epërm (Shtime)
3. Fadil Bajrush Rashiti (23) nga Petrova (Shtime)
4. Hafir Imri Bajrami (18) nga Zborci (Shtime)
5. Kadri Haki Ademaj (23) nga Petrova (Shtime)
6. Naser Shefki Kelmendi (22) nga Karaqica (Shtime)
7. Ramadan Deli Elshani (29) nga Shtimja (Shtime)
8. Selim Shaip Selimi (20) nga Belinci (Shtime)
9. Xheladin Hamdi Xheladini (22) nga Carraleva (Shtime)
10. Agron Mahmut Mehmeti (25) nga Shtrubullova (Drenas)
11. Faton Nazif Xhylani (17) nga Baica (Drenas)
12. Gani Halit Elshani (43) nga Krajkova (Drenas)
13. Luljeta Jahir Shala (21) nga Krajkova (Drenas)
14. Mentor Ramadan Ibriqi (19) nga Komarani (Drenas)
15. Muhamet Aziz Dërvishi (31) nga Gradica (Drenas)
16. Sylejman Zeqir Elashani (41) nga Gllobari (Drenas)
17. Xhevat Shaban Thaçi (29) nga Llapushniku (Drenas)
18. Bashkim Azem Krasniqi (21) nga Zllakuqani (Lipjan)
19. Enver Zymer Olluri (19) nga Krojmiri (Lipjan)
20. Isa Xhemshir Olluri (19) nga Krojmiri (Lipjan)
21. Qamil Hysen Olluri (22) nga Krojmiri (Lipjan)
22. Beqir Sefë Gashi (32) nga Mleçani (Malishevë)
23. Hazir Nezir Kryeziu (42) nga Mleçani (Malishevë)
24. Kadri Jahir Gashi (18) nga Balinca (Malishevë)
25. Maliq Hamëz Karaqica (49) nga Balinca (Malishevë)
26. Ali Halil Krasniqi (23) nga Çabiqi (Klinë)
27. Gani Hasan Zogaj (25) nga Rigjeva (Klinë)
28. Mujë Halil Krasniqin (31) nga Çabiqi (Klinë)
29. Agim Halil Mëziu (24) nga Marina (Skenderaj)
30. Ilir Hazir Asllani (29) nga Makërmali (Skenderaj)
31. Rifat Fazli Mëziu (30) nga Marina (Skenderaj)
32. Astrit Gafurr Bytyqi (18) nga Ferizaj
33. Hysni Shaip Kajtazi (19) nga fshati Tërn (Ferizaj)
34. Bekim Qamil Bytyqi (20) nga Dejna (Rahovec)
35. Isaj Muharrem Morina (40) nga Vrajaka (Rahovec)
36. Mevlan Tefik Hoxhaj (24) nga Zhuri (Prizren)
37. Qenë Avdyl Qenaj (41) nga Romaja (Prizren)
38. Avni Bislim Kutllovci (21) nga Sfaraçaku i Epërm (Vushtrri)
39. Besim Sylejman Qarri (20) nga Greiçeci (Suharekë)
40. Hysen Kadri Byjupaj (29) nga Istogu
41. Veli Beqir Ballazhi (20) nga Pusteniku i Hanit të Elezit

Pjesëtarët e UÇK-së që kanë luftuar ballë për ballë me forcat kriminale serbe, por që nuk kanë arritur të tërhiqen nga vija e rrethimit janë:

1. Azem Haqir Suma, 27 vjeçar nga Dimca e Hanit të Elezit,
2. Samet Aqif Ballazhi, 22 vjeçar nga Pusteniku i Hanit të Elezit,
3. Enver Liman Krasniqi, 26 vjeçar nga Karaqica e Shtimes,
4. Xhavit Daut Krasniqi, 17 vjeçar nga Duga e Shtimes,
5. Blerim Kadri Spahiu, 28 vjeçar nga Runiku i Skenderajt,
6. Merita Baftiar Ramadani, 16 vjeçare nga Likovci i Skenderajt,
7. Nazmi Sadri Bellaqa, 22 vjeçar nga Pataqani i Epërm i Rahovecit,
8. Sherif Sylejman Bellaqa, 28 vjeçar nga Pataqani i Epërm i Rahovecit,
9. Ismet Mursel Mazreku, 42 vjeçar nga Malisheva.

Për t'u tërhequr me sa më pak viktima në vijën e frontit, ushtarët e UÇK-së kanë zhvilluar luftime pakompromis e dhëmbë për dhëmbë me forcat e pritës armike. Në këtë betejë kanë marrë pjesë këta luftëtarë:

1. Avdull Leci nga Gradica (Drenas)
2. Avni Lestrani nga Bainca (Drenas)
3. Daut Kastrati nga Kizhnareka (Drenas)
4. Driton Rexhepi nga Strubullova (Drenas)
5. Elmi Shala nga Gjurgjica (Drenas)
6. Emin Thaqi nga Llapushniku (Drenas)
7. Fehmi Hoti nga Çikatova e Vjetër (Drenas)
8. Fetah Kiqina nga Bainca (Drenas)
9. Gazmend Nebihu nga Damaneku (Drenas)
10. Haxhi Kiqina nga Bainca (Drenas)
11. Imer Thaqi nga Llapushniku (Drenas)
12. Ismet Thaqi nga Llapushniku (Drenas)
13. Jashar Shala nga Negroci (Drenas)
14. Mehmet Fazliu nga Gradica (Drenas)
15. Mujë Ramadani nga Llapushniku (Drenas)
16. Naser Leku nga Bainca (Drenas)
17. Nasuf Thaqi nga Llapushniku (Drenas)
18. Nazmi Istogu nga Polluzha (Drenas)
19. Ramadan Bytyqi nga Gjurgjica (Drenas)
20. Rexhep Morina nga Gjurgjica (Drenas)
21. Sabit Morinanga Drenasi
22. Xhevdet Topalli nga Bainca (Drenas)
23. Aziz Elmi Amrushi nga Pjetërshtica (Shtime)
24. Bajram Hysri Gashi nga Pjetërshtica (Shtime)
25. Baki Behxhet Rashiti nga Petrova (Shtime)
26. Bashkim Beqë Beqaj nga Shtimja
27. Bedri Fetah Hysenaj nga Petrova (Shtime)
28. Emrush Muharrem Behluli nga Carraleva (Shtime)
29. Hyzri Hysni Muslija nga Belinci (Shtime)
30. Hyzri Rrahman Salihaj nga Mollopolci (Shtime)
31. Idriz Smajl Hysenaj nga Petrova (Shtime)
32. Isuf Shaban Abazi nga Godanci i Epërm (Shtime)
33. Nusret Ramadan Musliu nga Reçaku (Shtime)
34. Rifat Murat Mujota nga Mollopolci (Shtime)
35. Rrahman Jetullah Tafa nga Carraleva (Shtime)
36. Sadri Zenel Krasniqi nga Karaqica (Shtime)
37. Selajdin Sylejman Krasniqi nga Duga (Shtime)
38. Ylber Shefshet Spahija nga Pjetërshtica (Shtime)
39. Bajram Vehap Popaj nga Bellacërka (Rahovec)
40. Bashkim Fejzulla Morina nga Drenoci (Rahovec)
41. Haki Avdyl Morina nga Radosta (Rahovec)
42. Hashim Bilall Gashi nga Drenovci (Rahovec)
43. Hysen Nail Rexhepi nga Celina (Rahovec)
44. Ilir Zenel Popaj nga Bellacërka (Rahovec)
45. Jemin Rrustem Kelmendi nga Bellacërka (Rahovec)
46. Mensur Sefer Zyberaj nga Drenovci (Rahovec)
47. Pajazit Sahit Thaçi nga Dabidoli (Rahovec)
48. Shaban Vehapi nga Zatriqi (Rahovec)
49. Vesel Hamdi Krasniqi nga Drenovci (Rahovec)
50. Xhevdet Shaqir Mekani nga Drenovci (Rahovec)
51. Bislim R. Muçaj nga Lubizhda e Prizrenit
52. Burim Selim Krasniqi nga Prizreni
53. Ekrem Rexha nga Lubizhda (Prizren)
54. Elbasan Xhezahir Shoshaj nga Leskoveci (Prizren)



*Monumenti i përjetësisë për dëshmorët dhe pjesëmarrësit në betejën e Pashtrikut më 14 dhjetor 1998*

55. Namik Xhezahir Shoshaj nga Leskoveci (Prizren)
56. Nexhmedin B. Berisha nga Rogova (Prizren)
57. Ryshen Bislim Shala nga Nasheci (Prizren)
58. Sahit Sejdi Berisha nga Leskoveci (Prizren)
59. Selim Fazli Krasniqi nga Prizreni
60. Shukri Xhemaj nga Leskoveci (Prizren)
61. Xhemshit Rizan Krasniqi nga Prizreni
62. Bekim Gashi nga Balinca (Malishevë)
63. Esat Halilaj nga Llapçeva (Malishevë)
64. Shemsi Dobruna nga Llozica (Malishevë)
65. Sylë Halilaj nga Llapçeva (Malishevë)
66. Uka Gashi nga Vërmica (Malishevë)
67. Xhevxhet Berisha nga Carravrani (Malishevë)
68. Astrit Grabovci nga Peja
69. Florim Binak Qelaj nga Peja
70. Mahir Hasani nga Kuqishta (Pejë)
71. Musa Aliu nga Peja
72. Nysret Krasniqi nga Vranoci (Pejë)
73. Shkelzen Pepshi nga Peja
74. Avni Rizani nga Krojmiri (Lipjan)
75. Beqir Hamit Luma nga Kraishta (Lipjan)
76. Hazir Latif Murati nga Krojmiri (Lipjan)
77. Osman Zeqir Zeqiri nga Varigoci (Lipjan)
78. Xhevdet Qeriqi nga Krojmiri (Lipjan)
79. Enver Deliu nga Rrezalla (Skenderaj)
80. Naim Ferizi nga Plluzhina (Skenderaj)
81. Nexhat Haxhiu nga Kostërci (Skenderaj)
82. Vesel Aruqi nga Rrezalla (Skenderaj)
83. Bekim Berisha nga Dellova (Klinë)
84. Emin Gashi nga Klina
85. Naser Morina nga Gllareva (Klinë)
86. Sali Raci nga Jelloci (Klinë)
87. Avni Muhab Shiti nga Dimca (Hani i Elezit)
88. Mehmedali Misin Ballazhi nga Pusteniku (Hani i Elezit)
89. Vebi Shaban Mici nga Dimca (Hani i Elezit)
90. Hysni Kuçi nga Suhareka
91. Ylli Elshani nga Suhareka
92. Nuri Bexheti nga Dobroshi (Tetovë)

**Të dhënat statistikore sipas komunave të ushtarëve pjesëmarrës në betejën e Pashtrikut më 14 dhjetor 1998**

| Nr. | Komuna | Ushtarë dëshmorë | Ushtarë rob | Ushtarë pjesëmarrës | Gjithsej: |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Drenas | 8 | 0 | 22 | 30 |
| 2 | Shtime | 9 | 2 | 16 | 27 |
| 3 | Rahovec | 2 | 2 | 12 | 16 |
| 4 | Prizren | 2 | 0 | 11 | 13 |
| 5 | Malishevë | 4 | 1 | 6 | 11 |
| 6 | Lipjan | 4 | 0 | 5 | 9 |
| 7 | Skenderaj | 3 | 2 | 4 | 9 |
| 8 | Klinë | 3 | 0 | 4 | 7 |
| 9 | Pejë | 0 | 0 | 6 | 6 |
| 10 | Hani i Elezit | 1 | 2 | 3 | 6 |
| 11 | Suharekë | 1 | 0 | 2 | 3 |
| 12 | Ferizaj | 2 | 0 | 0 | 2 |
| 13 | Istog | 1 | 0 | 0 | 1 |
| 14 | Vushtrri | 1 | 0 | 0 | 1 |
| 15 | Tetovë | 0 | 0 | 1 | 1 |
| **GJITHSEJ:** | | **41** | **9** | **92** | **142** |

Epopeja e 41 heronjve të Kosovës të rënë në Pashtrik mori dhenë. Qëndresa e tyre po aq e madhe sa trimëritë legjendare të të parëve tanë, u bë një burim i madh frymëzimi që ftonte popullin për qëndresë e luftë të ashpër kundër pushtuesve serbë dhe tradhtarëve të vendit. *(Fund)*

# Agnes Marton, një poete e mrekullueshme



Agnes Marton është poete, shkrimtare, libretiste me origjinë hungareze, anëtare e Shoqërisë Mbretërore të Arteve (Mbretëria e Bashkuar). Botimet e fundit përfshijnë koleksionin e saj "Captain Fly's Bucket List" dhe katër përmbledhje me botimet Moria Books (ShBA). Ajo fitoi The National Poetry Day Competition në Mbretërinë e Bashkuar dhe për një antologji që ajo redaktoi (Estuary: A Conluence of Art and Poetry) fitoi Saboteur Award. Poezia e saj është gjerësisht e përfshirë nëpër antologji të ndryshme si, për shembull, "Alice - Ekphrasis at the British Library", 'Anthem: A tribute to Leonard Cohen'. Fiksioni i saj u quajt 'i jashtëzakonshëm' në Disquiet Literary Contest (USA). Në projektin fitues të Guardian of the Edge 33 të ekspozitës së poezisë, mblodhi artistë të ndryshëm vizualë, të cilët i përgjigjeshin poezisë së saj. Ajo ka qenë poete rezidente në Scott Polar Research Institute, Universiteti i Kembrixhit, në një Research Boat në Arctic Circle dhe, gjithashtu, në Islandë, Itali, Irlandë, Portugali, Kanada dhe ShBA. Aktualisht jeton në Luksemburg.

## Të jesh një Iguana[1]

*Sa e mërzitshme të hash*
*Ndiej të jem dobësuar*
*E zhvoshkur krejt*
*Si patatet e lira gati për zierje.*
*Zotëruesi im i ri pyet hallën time Agoninë,*
*Nëse e përkedhelura e tij e radhës e urren atë, zotëruesin.*
*Njëherë u përpoqa të shpëtoja*
*Dhe shkova mora zjarr prej Diellit.*
*E ndërsa jam robinë, unë ndihem dhe dragua.*
*I ngrë po vetë malet që kaptoj.*
*Po zvarritem nëpër akrepat e orës.*
*Vështroji dhëmbët e mi,*
*kthetrat e mia të lodhura,*
*bishtin tim të tharë.*
*Qëndroj brenda kufijve të mi, por sërish flas.*
*Zotëronjësi im nuk do të dëgjojë.*
*I them të më zgjojë për t'i ngrënë vaktet.*
*Gjithë ç'ha më mbetet në gjuhë*
*Ai më ka pagëzuar mua me emrin Oimirë,*
*por unë nuk i përgjigjem asnjë emri.*
*Njerëzve u pëlqen të zotërojnë nga një monstër*
*por ajo duhet të jetë*
*e pafuqishme sa edhe ata*

1 Një hardhucë e madhe pemësh, tropikale, amerikane, me një kreshtë gjëmbace gjelberoshe përgjatë shpinës, që rastësisht e mban si kafshë shtëpiake.

## Trashëgimi

*Gjyshi im kishte një shpirt prej safari*
*Ai u largua pa rënë në sy*
*përpara se kjo gjë të shndërrohej në prirje.*
*Na dërgoi një bisht luani.*
*si dhuratë.*
*Ne e përdorëm si fshirëse pluhurash.*

*

*Unë mbledh kartolina të vjetra*
*Ne nuk kemi albume*
*me fytyra për t'u brohoritur.*

*

*Macja e kishte gjuhën si të gjyshes sime,*
*si të nënës sime gjithashtu.*
*Unë trashëgova heshtjen ulëritëse.*

## Gruaja kaktus

*Ju kërkoni për gjurmë të vetes suaj.*
*Po ta dinit paraprakisht fundin tuaj të lumtur*
*ose zbraztësinë,*
*a do të luanit së bashku? Apo jo?*
*A do të zgjidhnit gjithsesi trillet e së pathënës?*
*Ç'do të bëje për të lehtësuar gjuhën tënde me gjemba,*
*mbetur ndër hymne dhe ninulla?*
*Ose bertasim nga prapa*
*ose vijmë vërdallë, rreth e rrotull,*
*gjysmë nervoze,*
*gjysmë të ndjeshëm?*
*Ti nuk mund të vendosësh apo përcaktosh në është etja,*
*Ti ndjehesh si një shtyllë kurrizore në rritje.*
*Mishi yt poroz nuk mund të preket.*
*Ke arritur në Luginën e Gëzimit, mbytur në pse-ra.*
*A ke mbërritur? Apo ende jo?*

## Prej bishës shndërrohem në superbishë

*Ti je unë (më drejtohet bisha).*
*Prej tani*
*Unë jam streha jote e panjohur.*
*Frikësoju ëndrrave të mia,*
*rend gjysmëzgjuar.*
*Piqu në helmin tim*
*si qershitë,*
*ndiqi udhët e mia.*
*Mos u lut, por tretu*
*në frymëmarrjen time verore.*
*Gjymtyrët tona janë*
*livadhe të mbivendosura,*
*peisazh i mjegullt mjalti.*
*Dhëmbët larg nga unë ose unë angullij,*
*(i drejtohem bishës).*
*Ngacmim i butë tronditës*
*duke shkelur gjithçka që mbaj.*
*Kush mendon ti se je.*
*Mos më shty drejt mbretërisë tënde.*
*Kush mendon ti se je.*
*Më lër vetëm, e ndërtoj vetë botën time.*
*I frigohem veç vetes, ëndraave të mia.*
*M'u zduk o bishë!*

## Shtegtim

*Ç'ndodh nëse ato shenja qiellore*
*më tradhëtojnë mua gjithashtu?*
*Sikur dielli të mbarojë*
*Si gjithçka tjetër*
*dhe po kështu fusha magnetike e tokës.*
*Po yjet?*
*Po sikur të mos ketë më një strehëz të tillë si shtëpia,*
*ose të jetë një hapësirë e majftë për zogjtë sendëtarë?*
*Çfarëdo të ndodhë*
*në një mënyrë a tjetër më duhet të shkoj,*
*me këngën e veriut, dallëndyshën e Arktikut,*
*zogjtë detarë bishtshkurtër,*
*një farë kohe duke numëruar ditët,*
*Pastaj pyetja: "A jam ende atje?"*
*Po sikur gjithçka të përsëritet apo dhe pse jo?*
*Do të uroja t'i thoja po një lloj jete*
*ose të mësoja si të harroja.*
*Sikur të mund t'i përzija hartat jashtë nga koka ime!*

## Të besosh në besim

*Kur fundosem, humbas sipërfaqen.*
*Frymëmarrjen e ashpër të ajrit.*
*Nuk mund të lutem, kurrë s'mësova se si.*
*Veç përsëris emrat*
*e miqve që s'i kam parë prej kohësh:*
*Ortrud Sturm, Fresia Puente,*
*Maria Teresa na bekon.*

## Björk

*Ja ku jam, unë, Stuhia e Kuqe!*
*Bërtas për t'u zbutur*
*dhe pëshpëris t'ju bëj juve të kapërdihemi së bashku,*
*kalojeni lart, lart, LART!*
*Mbyte zërin tënd*
*në përralla të rreme, gostira të bujshme.*
*Pastaj bashkoju tingujve të pastrehë,*
*duke i kërkuar ku ndodhen.*
*Ja ku jam, unë, shtriga me bisht derri,*
*plot magji të hijshme ujqërish dhe lojëra vogëlushësh,*
*ja ku jam, duke fluturuar, kali me tetë këmbë i Odinit.*
*Jam Primadona Shpresëmirë.*
*Djallushkë Ëmbëlakja jam!*
*Kërce!*
*Besoju harqeve ndërmjet kyçeve!*
*Pagëzoji me nga një emër balonat dhe fishekzjarret*
*jepu emra të tillë vendesh si Ëirrabilla,*
*që do të thotë Peshk i Djallosur.*
*Gazmend, deri në pafundësi. Kërce. Fërgëllo.*

## Udhëtim mahnitës

*S'kam qenë përherë e heshtur.*
*Dikur këndoja dhe rrëfeja histori.*
*Tani jam*
*e hutuar, e largët, diku në askundnajë.*
*(Strehuar thellë*
*jastëkësh të rehatshëm.)*
*(Tronditja e humbjes*
*Është diçka e dobishme.)*
*Tashmë po ndryshoj,*
*në përshtatje me terrin.*
*Tashmë eci tutje tëhu*
*duke u zmbrapsur,*
*forcë rehabilituese*
*jam tashmë.*
*Pastaj plot freski me sy të mjegulluar*
*projektoj*
*konturet përfundimtare të dritës.*
*Solemnitet depërtues.*
*Atëherë mundem të kuvendoj*
*krenar*
*dhe i paprekshëm.*

E rrallë

## Pinë verë të kuqe me aromë të keqe, vdesin 8 persona, 300 të tjerë në spital



Të paktën tetë persona në Filipine kanë vdekur dhe 300 të tjerë janë dërguar në spital pasi pinë verë kokosi në një lokal. Viktimat ishin nga qytete të ndryshme, por blenë pijen alkoolike, e njohur si lambanog, nga i njëjti dyqan. Pasi pinë pijen filluan të kishin dhimbje në stomak dhe marramendje. Shitja ilegale e lambanogos, që ka përmbajtje alkooli rreth 40 për qind, është e zakonshme.

FOTO E DITES




Retë shumëngjyrëshe shihen derisa dielli lind mbi qytetin Kronberg dhe ndërtesat e bankave në Frankfurt. /AP/

E jashtëzakonshme

## Drejtuesit të tramvajit i bie të fikët, pasagjerët marrin në dorë kontrollin




Pasagjerët e një tramvaji arritën që ta ndalonin atë pasi drejtuesi i saj kishte rënë pa ndjenja. Ngjarja ndodhi ditën e diel, ku një tramvaj në qytetin Bonn nuk ndaloi në disa stacione. Kjo ka shkaktuar panik te pasagjerët. Disa persona shkuan te kabina e drejtuesit dhe e gjetën atë pa ndjenja. Ata hynë me forcë dhe arritën ta ndalonin mjetin duke evituar një aksident të mundshëm. Një grua njoftoi kompaninë e transportit për të marrë direktiva se si mund ta ndalonin tramvajin.

BARSOLETA E DITËS



**Njërit i humbi gomari dhe duke e kërkuar bërtiste: - I lumi unë, i lumi unë! Njerëzit e dëgjonin me habi. Dikur e pyetën përse thoshte ashtu. Ai u përgjigj: - Si mos të them i lumi unë?! Çka nëse kisha qenë hipur mbi gomar?!**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

**Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00**

## The Addams Family / 3D




I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

**Rolet:** Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.
**Regjia:** Conrad Vernon And Greg Tiernan




**Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00**

## FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

**Rolet:** Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

**Regjia:** Chris Buck, Jennifer Lee

**Çdo natë në ora 19:00**

## FORD V FERRARI




Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

**Rolet:** Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfe, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.
**Regjia:** James Mangold




**Çdo natë në ora 21:30**

## TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

Regjia: Tim Miller

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Mund të ndiheni pak në siklet sot. Shumë njerëz do ta kërkojnë kohën dhe energjinë tuaj, kur ju në të vërtetë do të doni të përqendroheni në shtëpinë dhe familjen tuaj.



**DEMI**
Fjalët mahnitëse të këtij personi dhe biseda e mençur do t'ju argëtojnë dhe do t'ju bëjnë të njihni për disa aspekte të personalitetit tuaj për të cilat nuk keni qenë të vetëdijshëm më parë.



**BINJAKËT**
Shkoni në një udhëtim, apo vizitoni vendin tuaj të preferuar. Çfarëdo që të bëni, shijojeni në maksimum. Nuk është koha për të menduar për problemet e jetës, është koha të shkëputeni pak nga realiteti dhe të argëtoheni.



**GAFORRJA**
Ato janë sekretet tuaja dhe ju duhet t'i përhapni ato vetëm nëse dëshironi. Nëse do ia shprehni dikujt që ju pëlqen disa detaje që ju i keni kapur për personalitetin e tij, ai do të surprizohet dhe do t'ju pëlqejë edhe më shumë.



**LUANI**
Dëshira për të të ndihmuar e këtij personi mund të ketë një qëllim jo të mirë. Përpiquni që këtë kohë të jeni pak më të kujdesshëm ndaj njerëzve që nuk e kanë treguar ende veten e tyre.



**VIRGJËRESHA**
Komente të vogla që një mik i pëshpërit vetvetes mund të zbulojë të vërteta të mëdha, kështu që jini të vëmendshëm. Është koha që të merreni me këtë çështje njëherë e përgjithmonë dhe t'i largoni ndjenjat negative që keni pasur.



**PESHORJA**
Mund t'ju duket se keni ende dëshirë të jeni jashtë dhe ta shijoni jetën, por pasi të filloni të shijoni pak vetminë tuaj, do të kuptoni se keni bërë zgjedhjen e duhur.



**AKREPI**
Njerëzit e tjerë do të jenë në gjendje të sugjerojnë gjëra që nuk i kishit konsideruar më parë. Ata mund të të kujtojnë edhe detaje të vogla që mund të kryejnë një punë të madhe.



**SHIGJETARI**
Mendja juaj është e zënë me ide të mëdha dhe duke imagjinuar rezultate të mëdha, por harroni të lidhni këpucët. Kujdes, jini të vëmendshëm për çdo gjë, sepse detaje të vogla mund t'ju krijojnë problemet më të mëdha.



**BRICJAPI**
Duke iu përmbajtur identitetit tuaj, ju u tregoni njerëzve se jeni krenarë për atë që jeni dhe se jeni i fortë. Nëse veproni si dikush tjetër apo doni të dukeni si dikush tjetër do t'u tregoni njerëzve që nuk e dini se kush jeni.



**UJORI**
Kthehuni në kontakt me gjërat më të rëndësishme në jetë. Njerëzit tuaj do të donin një shans për të kaluar ca më shumë kohë me ju.



**PESHQIT**
Në çdo situatë të re që hasni sot, përpiquni të dukeni sikur e dini se çfarë po bëni, edhe nëse nuk bëni.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| INTER MILAN - BARCELONA | 1 | MONACO - CLUB BRUGGE | 1 | TOTTENHAM - PSV | GG3+ |

# Morina: Kam ofertë nga Ballkani dhe tri klube të tjera



Albutrint Morina është lënë i lirë nga Feronikeli, por ai brenda kësaj jave pritet të vendosë për klubin ku do ta vazhdojë karrierën. Ballkani është një prej klubeve që i ka bërë ofertë. "Po, mund të konfirmoj se jam në bisedime me katër klube. Një prej tyre është Ballkani. Emrat e tri skuadrave të tjera me dëshirë nuk do t'i zbuloja, por mund të them se një nga klubet që më ka bërë ofertë është në garë për titull. Për të ardhmen do të vendosi deri në fund të kësaj jave", ka thënë Morina

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 23 DHJETOR - Ish-kapiteni i Vëllaznimit të Gjakovës, Albutrint Morina, është në mesin e shtatë lojtarëve që skuadra kampione e Kosovës, Feronikeli, vendosi t'i lirojë pak kohë më parë. Morina ka thënë të hënën për gazetë se vendimi ka qenë befasues për këta futbollistë, për faktin se të njëjtët e ndihmuan skuadrën nga Drenasi të dalë fitimtare në të dy frontet: kampionat dhe garën e Kupës. Përveç Morinës, lojtarët e tjerë që janë lënë të lirë janë Astrit Fazliu, Kastriot Rexha, Arber Prekazi, Lulëzim Doshlaku, Haxhi Neziraj dhe Milosh Krkotiq. "Normalisht se është vendim që na ka befasuar të gjithëve, duke e ditur kontributin tonë për fitimin e trofeve. Klubi e ka një projekt me lojtarë të rinj dhe ne e respektojmë këtë vendim dhe i dëshiroj suksese", ka thënë Morina, i cili ka bërë me dije se kishte planifikuar edhe më herët që në janar të ndahet me skuadrën e "Niklit", pasi minutat që i kishte në dispozicion në sezonin vjeshtor ishin të paktë. "Të them të drejtën, edhe plani im ishte të ndërroj ambient gjatë këtij afati për shkak edhe të minutave të paktë në gjashtë muajt e fundit. Besoj se ky vendim i klubi do të më shërbejë për të mirën time që të gjej një skuadër që mund të kem më shumë hapësirë", ka shtuar ai.

Deri tash nga Feronikeli zyrtarisht është larguar vetëm Astrit Fazliu që është rikthyer në skuadrën e Dritës, derisa besohet se edhe Arbër Prekazi ka arritur marrëveshje me skuadrën kampione të vjeshtës, Ballkanin. Edhe futbollistët e tjerë janë në negociata me klubet e tjera, derisa Morina ka marrë katër oferta, në mesin e të cilave edhe nga Ballkani. "Po, mund të konfirmoj se jam në bisedime me katër klube. Një prej tyre është Ballkani. Emrat e tri skuadrave të tjera me dëshirë nuk do t'i zbuloja, por mund të them se një klub që me ka bërë ofertë është në garë për titull. Për të ardhmen do të vendos deri në fund të kësaj jave", ka thënë Morina. Skuadra e Feronikelit sezonin vjeshtor e mbylli në vendin e pestë me 27 pikë, kurse është kualifikuar në çerekfinale të Kupës së Kosovës.

## SHKURT

### Rrahmani arrin marrëveshje me Napolin

Kapiteni i Përfaqësueses së Kosovës, Amir Rrahmani, do të bëjë një tjetër hap të madh në karrierë, duke kaluar te Napoli gjatë verës së ardhshme. Mbrojtësi që luan te Verona pritet që shumë shpejt t'i kalojë vizitat mjekësore te klubi "Partenopei". "Tuttohellasverona.it" raporton se Napoli ka gjetur gjuhën e përbashkët me lojtarin dhe pritet që marrëveshja të mbyllet së shpejti. Ai me shumë mundësi do të mbetet te Verona dhe në verë do transferohet te Napoli. Kristiano Xhiuntoli këto ditë është duke punuar për marrëveshjen e Rrahmanit, por raportohet se Napoli do të firmosë edhe me Amrabat, lojtar tjetër që shkëlqen në radhët e Veronës. Klubi i Napolit pritet të bëjë një ofertë rreth 30 milionë euro për këtë goditje dyshe të merkatos së janarit.

### Uglari në kampin e FIBA-s për gjyqtarë

Gjyqtari Elldin Ulgari do të marrë pjesë në kampin e organizuar nga FIBA për Gjyqtarë Potencialë Nacionalë. Kampi i organizuar nga FIBA do të mbahet në Kortrijk të Belgjikës, nga 26 deri më 29 dhjetor. Ky kamp është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e gjyqtarëve të rinj, derisa Uglari ka gjykuar edhe në ndeshje ndërkombëtare. Kjo është edhe një dëshmi se Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) po investon në gjyqtarët e rinj. Katër gjyqtarë nga Kosova janë të licencuar nga FIBA dhe gjykojnë në gara të ndryshme evropiane.

### Zabergja largohet nga Vushtrria

Skuadra e Vushtrrisë ka kaluar në një edicion jo të mirë. Ndryshimi në trajnerë, por edhe rezultatet jo të mira, pritet të ndikojnë edhe në ndryshimet e lojtarëve në ekip. Largimin nga Vushtrria e ka konfirmuar mesfushori i njohur Dior Zabergja. "Me shumë gjasë do të largohem. Po pres vetëm të përfundojnë disa detyrime ndaj meje dhe më pas do të jem lojtar i lirë. Kam biseduar me kryesinë e klubit dhe e kemi parë të arsyeshme ta përfundojmë kontratën me marrëveshje. Mendoj se ka ardhur koha të ndërroj ambient", ka thënë Zabërgja për "Olle".

### Berisha dhe Shala përfaqësojnë Kosovën në kualifikimet online

Në ambientet e stadiumit "Fadil Vokrri" pas dy ditësh është përmbyllur me sukses turneu i parë i lojërave elektronike "eEuro2020 - PES2020" në organizim të Federatës së Futbollit të Kosovës e me përkrahje të kompanive "Xportal" dhe "Gjirafa50". Në këtë turne kanë qenë të përfshirë 128 lojtarë, të cilët kanë garuar me sistem eliminimi gjatë dy ditëve. Në ditën e parë fitues doli garuesi me nofkën Lorik Berisha, i cili në serinë finale prej tri ndeshjeve e mundi garuesin Shkumbin Gashi, ndërkaq në ditën e dytë në serinë finale fitues doli Genc Shala, i cili e mundi Gramoz Bajgorën. Finalistët u shpërblyen me nga një top dhe fanellë të kombëtares, derisa fituesit edhe me nga një "sony-playstation". Kësisoj, Kosovën në kualifikimet online do ta përfaqësojnë Lorik Berisha dhe Genc Shala.

## Ancelotti: Liga e Kampionëve nuk është mision i pamundur



LIVERPOOL, 23 DHJETOR - Shndërrimi i Evertonit në kandidat për Ligën e Kampionëve nuk do të jetë mision i pamundur, sipas trajnerit të ri të klubit nga "Merseyside", Carlo Ancelotti. Ish-trajneri i Chelseat, Real Madridit dhe Milanit ka nënshkruar kontratë me Evertonin deri në vitin 2024. Ai e merr në dorë një skuadër e cila momentalisht renditet në pozitën e 15 në Premierligë, vetëm katër pikë larg zonës së rrezikshme për rënie nga liga. "Liga e Kampionëve është synimi dhe qëllimi afatgjatë. Asgjë nuk është e pamundur në futboll", ka thënë Ancelotti.
Evertoni nuk ka marrë pjesë në Ligën e Kampionëve që prej vitit 2005, e cila është hera e vetme që ka marrë pjesë që prej vitit 1988. "Më ka tërhequr historia dhe tradita e klubit. Është një prej klubeve më të mëdha në Angli", ka shtuar Ancelotti.

# Federer: Synoj Wimbledonin dhe medaljen e artë në Tokio



CYRIH, 23 DHJETOR - Të gjithë presin të mësojnë se kur do të tërhiqet nga sporti tenisti Roger Federer, tashmë 38-vjeçar, njeriu që mban shumicën e rekordeve të këtij sporti. Megjithatë, zvicerani nuk ka ndërmend të ndalet këtu dhe mendon për sezonin e ri. Madje ai vetë ka deklaruar disa herë se nuk e ka idenë se kur do ta varë "raketën në gozhdë". "Ndoshta një ditë do të zgjohem dhe do të kuptoj se ka ardhur koha, por për momentin ajo ditë nuk po duket. Shpenzoj energjitë e mia për të qëndruar vazhdimisht në formë dhe për të qenë gati në çdo ndeshje që luaj", ka thënë Federeri. Një tjetër pyetje që të gjithë bëjnë është nëse Federeri është tenisti më i madh i historisë. "Në moshën time, asnjë tenist nuk ka mundur të fitojë një grand slam. Të jesh kompetitiv në këtë moshë kërkon shumë sakrifica. Unë stërvitem çdo ditë për të qenë gati. Tani stërvitem më pak, por ajo është me cilësi, pasi në këtë moshë nuk duhet të sforcohem shumë" u shpreh zvicerani. "Gjithsesi, nuk kam nevojë të fitoj në fushë për të treguar nëse jam më i madhi apo jo. Rëndësi ka që unë të argëtohem në fushë dhe fansat në stadium. Viti 2020? Shpresoj të fitoj në Wimbledon dhe ta marr medaljen e artë në Tokio", ka thënë Federeri.

# Milwaukee bën ligjin në Lindje, Lakersat dhe Clippersat pësojnë humbje




LOS ANGELES, 23 DHJETOR - Denveri i ka dhënë një leksion të mirë ekipit të Lakersave, duke fituar 128-104, sukses që ngjit skuadrën e Nuggetsit në vendin e dytë në Konferencën e Perëndimit. Mungesa e LeBron Jamesit u ndje shumë tek ekipi i Lakersave edhe pse Davisi shkëlqeu, duke realizuar 32 pikë e 11 rebounde. Për Denverin diferencën e bënë lojtarët e stolit, teksa realizuan 50 pikë, ndërkohë që shënuesi më i mirë ishte Millsap, autor i 21 pikëve, raporton "Telesport". Humbet edhe skuadra e Clippersave, që u mund 118-112 nga Oklahoma, sfidë e dominuar nga vendasit gjatë gjithë kohës. Shai me 32 pikë dhe Schroder me 28 pikë ishin më të mirët në fushë për Oklahomën, ndërsa për Clippers u dallua Lou Williamsi me 22 pikë, por që mbetën për statistikë (Leonard nuk luajti). Fiton skuadra e Bostonit, që mundi 119-93 ndaj Charlottes (Tatum 39 pikë e 12 rebounde). Në Lindje vazhdon të shkëlqejë skuadra e Milwaukees, që fitoi 117-89 ndaj Indianas dhe kryeson pa problem renditjen. Antetokounmpo realizoi 18 pikë e 19 rebounde. Fitojnë edhe kampionët e Torontos, që triumfuan 110-107 ndaj Dallasit, ndeshje me rivalitet dhe emocione në fundin e saj. Më i miri në fushë ishte Lowry me 32 pikë e 10 rebounde.

**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Toronto - Dallas | 110-107 |
| Boston - Charlotte | 119-93 |
| Milwaukee - Indiana | 117-89 |
| Oklahoma - Clippers | 118-112 |
| Lakers - Denver | 104-128 |

## SHKURT

### Zidane: Ronaldo nuk po i mungon Realit

